A.4	Aktivitete ne partneritet me te trete	15,000
	Shuma	17,250
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)
		Nga kjo: Paga Sigurime Operative Transferime Kap itale
	Shpenzime për aktivitete	17,250

	Shuma	17,250			17,250		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
1	Shpenzime për aktivitete	17,250			17,250		
	Shuma	17,250			17,250		
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor, 2026, 2027,2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 4	P.AF141.Q1.O1.A4 Memorial "Vllaznia", boks	AF141 Sport dhe Kulture				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Turne ndërkombëtar në boks						
i. Situata						
Ekipi i boksit i të rriturve, SK "Vllaznia", që në vitin 2002, merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare në bashkëpunim me federatën shqiptare të boksit sipas rregullores së Federatës Ndërkombëtare Europiane në boks in amator. Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë të ekipit kombëtar dhe 5 trajnerë. Ekipi i boksit të të rriturve ka marrë pjesë në këtë eveniment për 15 vite rresht duke dalë kampion në këtë aktivitet dhe duke marrë medalje ari, argjendi dhe bronzi, gjithsej 48 medalje. Në këto aktivitete prej 15 vitesh kanë marrë pjesë edhe shumë ekepe nga Kazakistani, Gjermania, Italia, Bullgaria, Hungaria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi, Kanadaja, Australia, Kroacia, Armenia, Irlanda etj. Ky aktivitet zhvillohet në nderim të boksierëve të cilët ngritën emrin e Vllaznisë në majat e boksit Shqiptar përgjatë viteve e sot nuk jetojnë më: Liman Kulla, Shyqyri Halili, Fadil Efovija, Ymer Gruda, Dervish Efovija, Ndoc Gjoni, Nazmi Halili, Kolec Ashiku, Lem Kosova, Shpresim Bregu, Kujtim Demi, Ramiz Halili e Fadil Zhega. Ne vitin 2025,boksierët garuan në 6 pesha të ndryshme 57 kg, 63.5 kg, 71 kg, 80 kg, 86 kg dhe 92+ kg, ku dhe fituesit përkatës u shpallën: Javier Diaz 57 kg (Bullgari), Edin Alkovic 63.5 kg (Mali i Zi), Rilind Murici 71 kg (Kosovë), Arjon Kajoshi 80 kg (Shqipëri), Milorad Puric 86 kg (Mali i Zi), Gelian Rajku 92+ kg (Shqipëri). Gjithashtu u shpallën edhe boksierët më të mirë të turneut ku boksieri më teknik u shpall Javier Diaz i ekipit të Bullgarisë dhe boksieri më i mirë Gelian Rajku i ekipit të Shqipërisë. Ndërsa ekipi më i mirë i aktivitetit u shpall ekipi i Shqipërisë.						
ii. Synimi i projektit						
- Organizimi i suksesshëm i aktivitetit ndërkombëtar "Memorial Vllaznia 2026. - Promovimi i sportit të boksit, i sportistëve të dalluar në qytetin e Shkodrës dhe në arenën ndërkombëtare						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
- Planifikim i organizimit të aktivitetit në bashkëpunim me trajnerët dhe organizatat e sportit të boksit. - Sigurim i mjeteve dhe aktiviteteve logjistike për mbarrëvajtjen e aktivitetit. - Ofrimi i bazës materiale që nevojitet për zhvillimin normal të këtij aktiviteti. - Organizim, monitorim dhe raportim i aktivitetit. - Likuidim financiar i shërbimeve të financuara.						
b) Rezultatet që prisni						
Ekipi synon të zërë vendin e parë, duke marrë medalje ari, argjendi e bronzi.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Shoqatat sportive Sponsorë Sportdashësit Bashkia Shkodër.			Bashkia Shkodër Federata Shqiptare e Boksit Donatorët e mundshëm			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Organizim i aktivitetit	500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime
	Shuma	500				500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Organizim i aktivitetit	500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime
	Shuma	500				500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Organizim i aktivitetit	500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime
	Shuma	500				500
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar – Dhjetor 2026, 2027, 2028		Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit				
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.5	P.AF141.Q1.O1.A5 Triathlon	AF141 Sport dhe Kulture						
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit: Garim me 3 sporte te ndryshme te permbledhura ne vetem 1 gare.								
i. Situata								
Triathlon është një garë multidisiplinore sportive me origjinë të hershme, por në epokën moderne, e ka zanafillën në vitin 1974, në San Diego të Californisë, USA. Është një aktivitet që përveç rezultateve sportive synon dhe promovon jetën e shëndetshme dhe socializimin në mes të atletëve. Bashkia Shkodër, në kuadër të zhvillimit të sportit dhe turizmit në liqenin e Shkodrës, organizon aktivitetin e përvitshëm "Triathlon Labeat" – një kompeticion tre garësh: not, çiklizëm dhe vrapim. Qëllimi i këtij aktiviteti është promovimi dhe nxitja e zhvillimit të sportit, si një mënyrë e shëndetshme e të jetuarit. Aktiviteti karakterizohet nga pjesmarrja e gjerë e sportistëve dhe amatorëve të sportit nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, rajonit dhe Europës. Aktivitete të tilla shërbejnë në promovimin e turizmit natyror në liqenin e Shkodrës, si një aset i pazëvendësueshëm i territorit dhe kontribuon në promovimin e burimeve dhe potencialeve që zotëron Liqeni i Shkodrës për zhvillimin e sporteve ujore dhe turizmit në tërësi.								
ii. Synimi i projektit								
- Të nxisë zhvillimin e aktiviteteve sportive ujore. - Të ndërgjegjësojë komunitetin për ruajtjen e mjedisit dhe pasurive ujore si Liqeni i Shkodrës.								
iii. Aktivitetet kryesore të projektit								
- Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për realizimin e aktivitetit; - Zhvillimi i tre-garëshit: not-vrapim dhe çiklizëm. - Shpallja e fituesve dhe ndarja e çmimeve.								
b) Rezultatet që prisni								
Ndërgjegjësim i rritur përvlerat sportive turistikedhemjedisore tëliqenit tëShkodrës.								
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt				
Bashkia Shkodër. DAR				Bashkia Shkodër Shoqatat Sportive				
e) Shpenzimet e llogaritura								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizim i aktivitetit	600				600		
	Shuma	600				600		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizim i aktivitetit	600				600		
	Shuma	600				600		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizim i aktivitetit	600				600		
	Shuma	600				600		
) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Janar – Dhjetor 2026, 2027,2028			Stafi i Drejtorisë së Sportit dhe Turizmit					
			Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 6	P.AF141.Q1.O1.A6 3x3Shkodra	AF141 Sport dhe Kulture					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit : Turne basketbolli 3-ditor profesionist							
i. Situata							
Bashkia Shkodër në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të basketbollit për të rinj dhe profesionistë, organizon për të katërtën herë 3x3 Shkodra pas atij në vitin 2024. Aktiviteti është i licensuar nga Federata Ndërkombëtare e Basketbollit (FIBA) dhe njihet si një ndër aktivitetet më popullore urbane në mbarë botën. Tashmë zyrtarisht edhe sport olimpike, 3x3 Streetball është faza e parë e këtij aktiviteti, pasi ekipi fitues ka mundësinë të shkojë në kategorinë tjetër më lart që zhvillohet në një vend tjetër të Evropës. Në aktivitetet pritet interes i lartë me pjesëmarrës nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, por edhe nga shtete të tjera si Mali i Zi, Kosova, Turqia, Spanja dhe Serbia. Gjithashtu në aktivitet përfshihen edhe sportistët U-18 të cilët kanë ndeshjet vecmas kategorisë Elite dhe 3- point contest. Në mbështetje të aktiviteteve rinore dhe sportive të cilat gjallërojnë jetën sociale të të rinjve të qytetit si dhe për promovimin dhe masivitetin e sportit të basketbollit, Bashkia Shkodër ka menduar të organizojë këtë aktivitet përsëri në Shkodër. Aktiviteti pritet të ketë interes të lartë dhe gjithashtu të ketë vëmendjen e mediave lokale dhe kombëtare pas suksesit të vitit të kaluar.							
ii. Synimi i projektit							
- Synojmë gjallërimin e jetës sportive në qytet. - Synojmë promovimin e sportit si instrument edukues. - Synojmë të mbështesim profesionistët kombëtarë të basketbollit. - Synojmë të promovojmë qytetin e Shkodrës për pjesëmarrës të huaj.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
- Ngritja e grupit të punës me pjesëmarrjen e të rinjve të cilët duan të angazhohen në organizim. - Programimi i aktiviteteve dhe axhendës së zhvillimit të aktivitetit. - Përzgjedhja e vendeve ku do të krijohen fusha e “3x3 Shkodra Streetball” - Përgatitja dhe ndërtimi i fushës. - Sigurimi i mjeteve të nevojshme si: rrjeta, mbajtëse të koshit, rrethimi i fushës, topat e basketbollit etj. - Sigurimi dhe pagesa për arbitrat dhe përgatitja e çmimeve për fituesit. - Sigurimi i vendqëndrimit për pjesëmarrësit.							
b) Rezultatet që prisni							
- Pjesëmarrje aktive e të rinjve në ndeshjet e 3x3 Shkodra Streetball. - Argëtim dhe zbavitje për qytetarët. - Promovim i sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti. - Mbështetje të profesionistëve në rang kombëtar. - Promovimi i turizmit në qytet.							
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt					
Bashkia Shkodër Mbështetës të aktivitetit		Bashkia Shkodër Federata shqiptare e Basketbollit Donatorë të mundshëm					
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1	Organizim aktiviteti	1,500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma	1,500				1,500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1	Organizim aktiviteti	1,500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma	1,500				1,500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1	Organizim aktiviteti	1,500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma	1,500				1,500	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Janar – Dhjetor 2026, 2027,2028		Drejtoria e Sportit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 7	P.AF141.Q1.O1.A7 Shkodra Open Tennis	AF141 Sport dhe Kulture				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit : Turne Nderkombetar i tenisit						
i. Situata						
Në qytetin e Shkodrës, sporti i tenisit ka marrë zhvillim duke numëruar kështu qindra fëmijë, të rinj dhe të rritur të cilët e ushtrojnë këtë sport. Bashkia Shkodër ka si qëllim të mbështesë të rinjtë drejt jetesës së shëndetshme dhe sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti. Shkodra Tennis Tournament është organizuar gjatë viteve të fundit nga organizata sportive të angazhuar në këtë shërbim. Edhe në vitin 2025, Bashkia Shkodër synon të bëhet pjesë mbështetëse e këtij turneu duke financuar për personelin ndihmës, arbitra, materiale dhe për dukshmërinë. Synojmë që çdo vit ky turne të fuqizohet duke tërhequr sa më shumë të rinjtë, për ta kthyer atë në një event të rëndësishëm.						
ii. Synimi i projektit						
• Synojmë gjallërimin e jetës sportive tek fëmijët dhe të rinjtë • Synojmë promovimin e sportit si instrument edukues. • Promovimi i sportit si veprimtari sociale, integruese dhe burim shëndeti. • Synojmë të mbështesim profesionistët dhe amatorët e tenisit						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
▪ Detajim i mbështetjes së aktivitetit sipas kërkesës së organizatës së tenisit në Shkodër. Kjo mbështetje mund të jetë: • Sigurim i mjeteve dhe aktiviteteve logjistike për mbarëvajtjen e aktivitetit. • Ofrimi i bazës materiale që nevojitet për zhvillimin normal të këtij aktiviteti. ▪ Organizim, monitorim dhe raportim i aktivitetit. ▪ Likuidim financiar i shërbimeve të financuara.						
b) Rezultatet që prisni						
• Argëtim dhe zbavitje për të rinjtë • Promovim i sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti. • Mbështetje të profesionistëve dhe amatorëve në nivel kombëtar.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër Mbështetës të aktivitetit			Bashkia Shkodër Federata shqiptare e Tenisit Donatorë të mundshëm			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
A.1	Organizim aktiviteti	600	Paga	Sigurime	Operative	Transferime
	Shuma	600				600
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
A.1	Organizim aktiviteti	600	Paga	Sigurime	Operative	Transferime
	Shuma	600				600
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
A.1	Organizim aktiviteti	600	Paga	Sigurime	Operative	Transferime
	Shuma	600				600
f f) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			
Janar – Dhjetor 2026, 2027,2028			Drejtoria e Sportit			
			Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr.8	P.AF141.Q1.O1.A8. Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e terreneve sportive.	AF141 Sport dhe Kulture
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Mirëmbajtje e objekteve, terreneve, fushave sportive të Bashkisë Shkodër.		
i. Situata		
Pallati i sportit “Qazim Dervishi” pronë e Bashkisë Shkodër është përdorur dhe mirëmbajtur nga Sport Klub Vllaznia deri në mu ajin Qershor 2021. Përmes VKB nr. 18 dt. 25.03.2021 “Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, programi sport dhe argëtim, përmes metodologjinë LOD, pas mbylljes së funksionimit të Sport Klub Vllaznia” ky institucion është mbyllur dhe administrimi i këtij impianti bëhet nga Bashkia Shkodër. Stadiumi “Loro Boriçi” është pasuri e paluajtshme, pronë publike, në pronësi të Bashkisë Shkodër. Kjo pronë ka kaluar në pronësi të Bashkisë Shkodër me VKM nr. 421, datë 2.6.2010 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër”, me nr. 221 rendor në listë të inventarit. Këshilli Kombëtar i Territorit të Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 1, datë 1.4.2015 ka miratuar kërkesën e Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) për të investuar në rikonstruksionin e këtij objekti. Përfutues i këtij investimi është Bashkia Shkodër. FSHF dhe Bashkia Shkodër kanë nënshkruar një Marrëveshje (Nëntor 2015) me qëllim bashkëpunimin për rikonstruksionin, përdorim in dhe manaxhimin e këtij impianti sportiv në pronësi të Bashkisë Shkodër pas realizimit të konstruksionit të Stadiumit “Loro Boriçi”. Me datë 06.03.2019 në prani të personit të autorizuar nga Bashkia Shkodër u dorëzua nga personi i autorizuar nga FSHF dokumentacioni origjinal: Relacion përmbledhës i mbikëqyrës të punimeve, Situacion përfundimtar i punimeve, Akt kolaudimit përfundimtar të projektit, Shkresë nga UEFA ku stadiumi plotëson standartet e kategorisë 4, Certifikatë e përhershme e marrjes në dorëzim, Libreza e mas ave dhe vizatime të stadiumit final. Të gjitha institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore krijojnë kushtet e nevojshme që nxënësit, studentët, efektivat e policisë dhe të Forcave të Armatosura të zhvillojnë veprimtari fizike dhe sportive, individuale dhe/ose të organizuara. Njësia administrative e pushtetit vendor harton dhe garanton politikat vendore në fushën e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitari, krijon institucione përgjegjëse për sportin, menaxhon objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës, mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre. Bashkia Shkodër ka filluar procedurën për marrjen në dorëzim të punimeve të objektit të Stadiumit “Loro Boriçi” dhe mirëmbajtjen e tij. Janë kryer pagesat për shërbimin e rojeve dhe pagesat për shërbimet utilitare të tij. Fusha sportive “Reshit Rusi” është një nga infrastrukturat sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër ku zhvillohen trajnimet dhe ndeshjet e akademisë së futbollit, për ekipet e grupmoshave si dhe për zhvillimin e ndeshjeve futbolistike sidomos në rastet kur luajnë moshat. Dhe ka nevojë për një rikonstruksion të përgjithshëm si objekt për t’iu përgjigjur standarteve bashkëkohore sportive. Bashkia Shkodër realizon pagesat për shërbimin e rojeve dhe shërbimet utilitare si ujë, energji elektrike për stadiumin “Loro Boriçi”, pallatin e sportit “Qazim Dervishi” dhe fushën sportive “Reshit Rusi”. Për vitin 2026 eshte parashikur blerja e nje mjeti pune scissor lift per riparimet e ndricimit në stadium, pallatit sportit dhe fushave sportive qe ben te mundur ngritje të sigurt të punonjësve, pasi kryerja e shërbimeve ne lartesi behet me shkalle dhe nuk eshte e sigurt per punonjesit.		
ii. Synimi i projektit		
- Garantimi i kushteve në stadiumin “Loro Boriçi”, në fushën sportive “Reshit Rusi” dhe pallatin e sportit “Qazim Dervishi” Shkodër në përputhje me standardet e FIFA, UEFA dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar - Rritja e cilësisë sportive të futbollit të qytetit të Shkodrës - Organizimi i aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare të futbollit dhe të sporteve të tjera në këto objekte sportive.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
- Aktiviteti kryesor është mirëmbajtja e ambjenteve sportive të Stadiumit “Loro Boriçi”, fushës sportive “Reshit Rusi” dhe Pallatit të Sportit “Qazim Dervishi”. - Të gjitha ambjentet e Stadiumit “Loro Boriçi” dhe Pallatit të Sportit “Qazim Dervishi”, në zbatim të LIGJ Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar , do të jenë në funksion të Organizimit të aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. LIGJ Nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar krijimi i kushteve të nevojshme për zhvillimin sistematik nga të gjitha moshat të edukimit fizik dhe sportit, të mbështetura nga institucionet e pushtetit qendror dhe njësitë e qeverisjes vendore; - Vënia në dispozicion e ambjenteve sportive mbështetëse pa pagesë, për përdorim, për zhvillimin e aktivitetit sportiv përmes marrëveshjeve me shoqatat sportive. - Punë të mirëmbajtjes së përditshme, facilitim të zhvillimit të aktivitetit sportiv. - Monitorim dhe raportim i aktivitetit që zhvillohet në këto struktura. - Likuidim financiar i personelit që shërben dhe i shërbimeve të financuara. - Pagesa për shërbimin e rojeve dhe shërbimet utilitare si ujë, energji elektrike për stadiumin “Loro Boriçi”, pallatin e sportit “Qazim Dervishi” dhe fushën sportive “Reshit Rusi”.		
b) Rezultatet që prisni		
- Stadiumi “Loro Boriçi”, Fusha sportive “Reshit Rusi” dhe Pallati i Sportit “Qazim Dervishi” mirëmbahen në kushte optimale për zhvillimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare të futbollit dhe të sporteve të tjera. - Terrene sportive në kushte optimale të vëna në dispozicion për stërvitjen e ekipeve të angazhuara nga shoqatat sportive, me të cilat Bashkia e Shkodrës ka marrëveshje bashkëpunimi në disiplina të ndryshme sportive.		
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt	
K.F. “Vllaznia” Shoqatat Sportive	Bashkia Shkodër	

e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzim ruajtje te godines	6,000			6,000		
A.2	Shpenzime energji elektrike	12,000			12,000		
A.3	Shpenzime ujë	2,000			2,000		
A.4	Shpenzime karburanti	530			530		
A.5	Shërbim interneti	200			200		
A.6	Blerje materiale pastrimi	100			100		
A.7	Rimbushje kolaudim fikëse zjarri	230			230		
A.8	Blerje kancelari	20			20		
A.9	Blerje materiale elektrike, hidraulike, bojë muri, vegla pune dhe mjete për mirëmbajtje të përgjithshme	320			320		
A.10	Mirembajtje salla e atletikes	10,000			10,000		
A.11	Blerje mjet pune "Scissor Lift"	1,500					1,500
A.12	Zevendesimi i uleseve stadiumi Loro Boriçi	20,000					20,000
	Shuma	52,900			31,400		21,500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Administrimi dhe Mirëmbajtje e objekteve/ terreneve sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër	25,000			25,000		
	Shuma	25,000			25,000		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Administrimi dhe Mirëmbajtje e objekteve/ terreneve sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër	25,000			25,000		
	Shuma	25,000			25,000		
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Sportit					
Janar – Dhjetor 2026, 2027, 2028		Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike					

Nr. 9	P.AF141.Q1.O1.A9 Mbështetje per ekipet sportive Vllaznia.	AF141 Sport dhe Kulture
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit :		
i. Situata		
Bashkia Shkodër, në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 25 “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”, pika 4, është përgjegjëse për “Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve” duke mbështetur zhvillimin e sportit si funksion të saj përmes financimit me grante per shoqata sportive. Me datë 27.07 2020, me propozimin e Këshillit të Ministrave, janë miratuar në Kuvendin e Shqipërisë ndryshimet në Ligj 79/2017 “Për Sportin” i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit në fletoren zyrtare, përkatësisht në datën 10.09.2020. Këshilli Bashkiak ka miratuar Vkb nr. 69, date 30.10.2017 'Per miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndermjet programit për zhvillim të kombeve të bashkuara dhe bashkise shkodre si dhe miratimin e metodologjisë lod për financimin e organizatave të shoqërisë civile' dhe vkb nr. 18 me datë 25.3.2021, ku Financimi I sporteve do vijoje me grante per shoqata sportive dhe do behet sipas objektivave ,cilesise dhe rezultateve te sporteve. Duke qene se ky program mbaron ne muajin dhjetor 2025, do te hapet thirrja e re publike per financimin e shoqatave sportive per vitin ne vijim, dhe financimi i sporteve do te behet sipas objektivave dhe rezultateve.		
Në vitin 2025 Bashkia Shkodër ka realizuar kontratën me shoqatën e basketbollit “Vllaznia” me ekipe meshkuj te rritur dhe te rinj, te rritura dhe te reja, duke respektuar procedurën e thirrjes së hapur për pjesëmarrjen e shoqatave sportive për të ofruar trajnimin dhe organizimin e aktivitetit sportiv për të rinj dhe të rritur. Ekipi i basketbollit i të rriturve të meshkujve “Vllaznia” është pjesë e Shoqatës Vllaznia që në vitin 1926 dhe merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHB. • Ekipi i Basketboll i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 të rinj që angazhuar me basketboll dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 9 herë në vitet 1967,1990,1993,1997,1998,2000,2014,2015,2016. Fitues i kupës së Republikës 12 herë në vitin 1957, 1959, 1966, 1967, 1968, 1981, 1985, 1994,1996,1998,2014,2015. Ekipi të rritur vend i 2 per vitin 2025. Mbështetja e ekipeve zinxhir, e të rinjve të moshave është një ndër mënyrat e mbështetjes së Bashkisë Shkodër, për të nxitur dhe promouar edukimin sportiv. Janë shumë të rinj që marrin pjesë në ekipet e të rinjve, dhe nga vit në vit ky numër shtohet. Ata angazhohen në aktivitete sportive, në aktivitete masive, duke u rritur shëndetshëm dhe profesionalisht. Ekipi të rinj – Vend i 3 per vitim 2025. Janë 15 vajza të rritura të angazhuara në ekipin e sportit të basketbollit. Ato trajnohen dhe marrin pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Ekipi të rritura - Vend i 4-rt Kampionat Kombëtar per vitin 2025. Janë 15 vajza të reja të angazhuara në ekipin e sportit të basketbollit. Ato trajnohen dhe marrin pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Ekipi të reja – Vend i 3 per vitin 2025.		
• Në vitin 2025 pas thirrjes së hapur për pjesëmarrje të shoqatave sportive, dhe realizimit të procesit të vlerësimit sipas metodologjisë, është lidhur marrëveshja me shoqatën e volejbollit për të rritur dhe te rinj. Janë 15 djem të angazhuar në ekipin e sportit të volejbollit. Ata trajnohen dhe marrin pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Ekipi i volejbollit si pjesë e Shoqatës Vllaznia që në 1924 merr pjesë në veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHV. Ekipi i të rriturve përbëhet nga 15 rritur dhe 2 trajnerë. Fitues i kupës së Republikës 3 herë në vitet 1969, 1970, 1973.Kampion Kombëtar për herë të parë në vitin 2017. Në sezonin e ri ekipi synon të jetë pjesë e katër ekipeve më të mira të kampionatit. Ekipi të rritur (Senior) – Vend i 4-rt në Kampionat Kombëtar. Ekipi të rinj – Vend i 2- të Kampionat Kombëtar. Ekipi të rritura (Senior) – Vend i 4 Kampionat Kombëtar per vitin 2024. Ekipi të reja – Finale të Kampionatit Kombëtar		
• Ekipi i boksit SK “Vllaznia” si pjesë e Shoqatës Vllaznia që në vitin 1947 dhe më pas me rifillimin e këtij sporti pas vitit 1990, merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHB. Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 20 të rritur dhe 3 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 25 herë, në vitet 1951, 1991– 1995, 1997– 2013 dhe 2015– 2023 Fitues i kupës së Republikës 20 herë në vitet 1991– 1995 dhe 1997–2013. Ekipi është kampion në fuqi dhe ka si synim të vazhdojë të jetë kampioni Shqipërisë edhe për sezonin e ri sportiv. Fitues të turneut “Memorial Vllaznia 2025.		
• Ekipi i atletikës SK “Vllaznia” si pjesë e Shoqatës Vllaznia që në vitin 1920 merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHA. Kampion në fuqi dhe me objektiv për të dalë kampion përsëri edhe në 2024. Sportisti Franko Burraj është shpallur kampion dhe rekordmen kombëtar dhe vazhdon të mbajë statusin e sportistit elitë Kampion te Kampionatit Kombetar dhe të Kupës së Shqipërisë per vitin 2025.		
• Ekipi i Ciklizmit të të rriturve SK “Vllaznia” si pjesë e Shoqatës Vllaznia që në vitin 1905 merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHC.Ekipi i ciklizmit të të rriturve të Vllaznise përbëhet nga 8 të rinj dhe 3 trajnerë.Ky ekip ka zënë vende të para në kampionatet kombëtare (Rrethi ciklistik i Shqipërisë) 7 herë në vitet 1982, 1984, 1985, 1998, 1989, 1995, 1997.Ky ekip ka të rinj të talentuar dhe me prespektivë, ku në vitet 2017, 2018, 2019 dolën kampionë si individë ashtu edhe si ekip. Ekipi të rritur (Senior)- Vend i 3. Vend i 2- të Bruno Kola (Trofeu Tirana)		
• Ekipi i Gjimnastikës “Vllaznia” si pjesë e Shoqatës Vllaznia që në vitin 1949 merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregullores së FSHGJ.Ekipi përbëhet nga 10 të rritura dhe 1 trajner.Ekipi i gjimnastikës ka zënë vendin e parë në vitet 1976-1977, ndërsa ekipi i gjimnastikës i për femra ka zënë 6 herë vendin e parë në kampionatet në vitet 2005, 2006, 2008, 2013, 2014, 2015. Kampion edhe për vitin 2025 per femije		

• Ekipi i mundjes SK "Vllaznia" si pjesë e Shoqatës Vllaznia, që në vitin 1946, merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHM. Ekipi i të rriturve të Vllaznisë përbëhet nga 10 të rritur dhe 1 trajner. Ky ekip ka dalë N/kampion 2 herë në vitet 2009, 2010, nga vitit 2010 dhe deri 2019 renditet në vendin e tretë. Të rinj sportistë cilësorë, kampionë individual për këto vite kanë dalë 5 sportiste. Objektivat e ekipit janë: Pjesëmarrje në Kampionat e Kupën e Republikës sipas kalendarit të FSHM. • Ekipi i notit Vllaznia si pjesë e Shoqatës Vllaznia që në vitin 1920 merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHN. Ekipi i notit i Vllaznisë përbëhet nga 15 të rinj dhe 1 trajner. Në gara individuale ka pasur shumë rezultate të larta, gjithsej 30 medalje ari, argjendi dhe bronzi për femije e te rinj. • Ekipi i Peshëngritjes Vllaznia si pjesë e Shoqatës Vllaznia qw në vitin 1946 merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHP. Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 10 të rritur dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 8 herë në vitet 1972, 1973, 1976, 1978, 1991, 2004, 2008, 2009. Fitues i kupës së Republikës 4 herë në vitet 1977, 1988, 2010, 2011. aktualisht ekipi merr pjesë me te rinj dhe para te rinj, • Ekipi i Ping-pongut i të rriturve Vllaznia, si pjesë e Shoqatës Vllaznia që në vitin 1965 deri në 1985 dhe me rifillimin e aktiviteteve të këtij sporti pas vitit 1990, merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHP. Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 8 të rritur dhe 1 trajner. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 6 herë në vitet 1966, 1968, 1970, 1975, 1982, 1983. Ky ekip, që në vitin 1990 merr pjesë rregullisht në kampionatin kombëtar dhe kupat e Republikës duke zënë vende të dyta dhe të treta. • Ekipi i Shahut SK "Vllaznia", si pjesë e Shoqatës Vllaznia, që në vitin 1944 merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHS. Ekipi i te rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 8 të rritur dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 1 herë në vitin 2008. • Ekipi i Xhudos si pjesë e SK Vllaznia, që në vitin 1991, merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHJ. Ekipi përbëhet nga 40 kadetë (grupmoshat), 30 të rinj dhe të rritur dhe 2 trajnerë. Kupa e Republikës ka filluar të organizohet që nga viti 2001 me emrin "Kupa Anton Shkoza". Gjithsej ekipi Vllaznisë është shpallur 9 herë kampion i Kupës së Republikës. Në vitin 2016 ekipi i Vllaznisë në xhudo shpallet sërish kampion kombëtar për të 20-tën herë në të gjitha disiplinat, për të rritur, për të rritura dhe grupmoshat. Ekipi i Xhudos merr pjesë në shumë aktivitete ndërkombëtare gjatë vitit duke përfaqësuar denjësisht në këtë disiplinë qytetin e Shkodrës. Themeluesit të xhudos në qytetin e Shkodrës Anton Shkoza i është akorduar mirënjohje e veçantë nga Federata Botërore e Xhudos në botë për kontribut ndërkombëtar. Ekip kampion me 3 sportiste elitare. • Ekipi i Vllaznisë në boks për femra, ka sportiste që stërviten në sportin e boksit. Sportistja Elsidita Selaj është shpallur kampione në turneun "Memorial Vllaznia" 2025. • Ekipi i parë është i përbërë nga 25 vajza futbolliste. Po ashtu funksionon edhe ekipi i vajzave të vogla prej 20 vajzash. Ekipi i futbollit të femrave të Vllaznia ka edhe objektiva afatgjata. Përveç krijimit të ekipit U13, do të nisë puna shumë shpejt për krijimin edhe të ekipit U15 dhe gradualisht më pas, për të plotësuar të gjithë organikën e ekipeve të sistemit zinxhir në mënyrë që e ardhmja e ekipit të parë të Vllaznisë të jetë e garantuar me këta elementë që do të dalin nga këto ekipe. Përpos këtij synimi, do të vijohet puna për rritjen e cilësisë së ekipit të parë duke synuar jo vetëm vijimin e sukseseve në arenën kombëtare, por edhe një sukses sa më të madh në pjesëmarrjen në kompeticionet europiane. Pjesëmarrje e rregullt në Champions League dhe Kampion Kombëtar i padiskutueshëm 12 vite rresht. • Ekipi i Taekwondosë është krijuar në vitin 2013 dhe merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHT. Ekipi përbëhet nga 100 kadetë (grupmoshat), 30 të rinj dhe të rritur dhe 4 trajnerë. Ky ekip i formuar nga pasioni dhe dëshira e trajnerve për ta ngritur si sport, ka patur masivizimin në të madh nga ekipet e qytetit. Ekipi i taekwondosë merr pjesë në shumë aktivitete ndërkombëtare gjatë vitit duke përfaqësuar denjësisht në këtë disiplinë qytetin e Shkodrës. Tre vitet e fundit këto sportiste kanë arritur rezultate të larta me ekipet e te rinjve dhe para te rinjve duke fituar shume medalje ari dhe argjendi. Themeluesit të xhudos në qytetin e Shkodrës Elion Puka i është akorduar mirënjohje e veçantë nga Federata Shqiptare e Taekwondosë për promovimin e këtij sporti në rang kombëtar po jo vetëm. • Ekipi i parë i Futsalles është i përbërë nga 14 futbolliste. Përveç krijimit të ekipit, do të nisë puna shumë shpejt për krijimin edhe të ekipeve zinxhir gradualisht, për të plotësuar të gjithë organikën e ekipeve të sistemit zinxhir në mënyrë që e ardhmja e ekipit të parë të Vllaznisë të jetë e garantuar me këta elementë që do të dalin nga këto ekipe. Përpos këtij synimi, do të vijohet puna për rritjen e cilësisë së ekipit të parë duke synuar jo vetëm vijimin e sukseseve në arenën kombëtare, por edhe një sukses sa më të madh në pjesëmarrjen në kompeticionet europiane.
ii. Synimi i projektit • Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit. • Promovimi i sportit si veprimtari sociale, integruese dhe burim shëndetit. • Garantimi i pjesëmarrjes ekipeve të "Vllaznia" në Kampionatet Kombëtare me synim arritjen e rezultateve cilësore.
iii. Aktivitetet kryesore të projektit • Vënia në dispozicion e ambienteve sportive mbështetëse pa pagesë, për përdorim, për zhvillimin e aktivitetit sportiv përmes marrëveshjeve me shoqatat sportive. • Sigurimi i kushteve të stërvitjes në pallatin e sportit ose palestra shkollore në bashkëpunim me ZVAP sipas kalendarit sportiv të hartuar në bashkëpunim me shoqatat sportive. • Mbështetja e dhe rritja e kapaciteteve të shoqatës zbatuese të projektit sportiv. • Mbështetja e trajnerëve dhe të rriturve pjesëmarrës në aktivitetin sportiv, sipas marrëveshjes me shoqatën sportive. • Sigurimi i mjeteve dhe aktiviteteve logjistike për mbarrëvajtjen e aktivitetit sportiv, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me shoqatën sportive. • Facilitim, monitorim dhe raportim i aktivitetit. • Likuidim financiar i shërbimeve dhe mbështetjes së financuar nga Bashkia Shkodër.

b) Rezultatet që prisni								
• Ekipi arrin objektivat e synuara në projekt								
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt					
Shoqata sportive Sportdashësit Bashkia Shkodër			Bashkia Shkodër					
e) Shpenzimet e llogaritura								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mbështetje per ekipet sportive Vllaznia		44,000				44,000	
	Shuma		44,000				44,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mbështetje per ekipet sportive Vllaznia		44,000				44,000	
	Shuma		44,000				44,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mbështetje per ekipet sportive Vllaznia		44,000				44,000	
	Shuma		44,000				44,000	
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2026 Gjatë vitit 2027 Gjatë vitit 2028			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria pergjegjese, Drejtoria e Kulturës dhe Sportit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 10	P.AF141.Q1.O1.A10 Shpërblim për rezultatet në arenën kombetare dhe ndërkombëtare për sportistët e trajnerët që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës	AF141 Sport dhe Kulture				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit :						
i. Situata						
Janë disa ndër sportistët e Shkodrës, që luajnë sporte individuale apo ekip, duke përfaqësuar Shkodrën, arrijnë të kenë rezultate të merituar të lavdërueshme, kryesuese në garat apo kompeticionet ndërkombëtare. Ata, duke përfaqësuar Shkodrën në këto nivele, nderojnë qytetin tonë dhe përcjellin emrin dhe imazhin e mirë përmes sportit. Bashkia Shkodër, duke i dalluar dhe duke i vlerësuar ata, mbështet sakrificën, sfidën, arrijtet dhe punën e madhe të këtyre sportistëve dhe trajnerëve, Kjo mbështetje mund të shërbejë edhe si një shtysë për të arritur këto rezultate e për t'u përfaqësuar sa më mirë në nivelin ndërkombëtar. Më Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 789 datë 15.12.2021, I ndryshuar, janë përcaktuar kriteret, mënyra e shpërblimit dhe trajtimit të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre. Ky vendim do të zbatohet në rastet kur sportistët me status të nivelit të lartë arrijnë rezultatet sipas kriterëve të përcaktuara në VKM.						
ii. Synimi i projektit						
- Synojmë promovimin e sportit si instrument edukues. - Synojmë të mbështesim profesionistët, sportistë dhe trajnerë për rezultate në nivelin ndërkombëtar.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
- Evidentimi i sportistëve dhe trajnerëve që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës, që kanë arritur rezultate në nivelin kombëtar gjatë vitit 2025. - Vlerësim i shpërblimit për sportistë dhe trajnerë - Organizimi i eventit dhe dhënia e mbështetjes - Monitorim dhe raportim i aktivitetit. - Likuidim financiar i shërbimeve të financuara..						
b) Rezultatet që prisni						
- Promovim i sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti. - Mbështetje e atyre sportistëve dhe trajnerëve që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës, për rezultate në nivelin kombëtar						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër Mbështetës të aktivitetit			Bashkia Shkodër Federata shqiptare e Basketbollit Donatorë të mundshëm			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Shpërblim për sportistët e trajnerët	5,500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
Shuma		5,500			5,500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Shpërblim për sportistët e trajnerët	5,500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
Shuma		5,500			5,500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Shpërblim për sportistët e trajnerët	5,500	Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
Shuma		5,500			5,500	
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2026 Gjatë vitit 2027 Gjatë vitit 2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria përgjegjëse, Drejtoria e Kulturës dhe Sportit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 11	P.AF141.Q1.O2.A1 Nderim i ambienteve sportive te gjimnazit "28 Nentori"	AF141 Sport dhe Kulture
--------	--	----------------------------

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	Firma e propozuesit te Projektit	
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit	dpmop@bashkiashkoder.gov.al		
Institucioni Buxhetor Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkodër	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02. Identifikimi i Idesë se Investimit

Projekt Idea	Nderim i ambienteve sportive te gjimnazit "28 Nentori", Shkoder
Problemet për tu adresuar	Shkolla 28 Nentori eshte nje nga shkollat e Mesme te para te Qytetit te Shkodres me nje tradite edukimi te gjate ku breza te shumte kane kryer me sukses shkollimin. Ne kete shkolle aktualisht frekuentojne mesimin 612 nxenes duke bere nje nga shkollat e mesme me te frekuentuara te qytetit. Shkolla ndodhet ne qender te qytetit dhe ka nje infrastrukture te mire persa l perket godines dhe mjediseve te jashtme. Nderkohe sa l perket palestres se shkolles ajo e ka humbur funksionin e saj per shkak te amortizimit ne vite. Per kryerjen e aktiviteteve rekreative dhe sportive eshte shume me shume vlere qe kjo shkolle duke marre parasysh edhe numrin e larte te nxenesve te kete edhe mjedise te brendshme, te mbyllura ne te cilat mund te zhvillohen keto aktivitete.
Emri i Programit	AF141 Kultura, Sporti, Argetim
Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen	Ky mjedis i rikualifikuar pervec perdorimit nga nxenesit e shkolles gjate orarit te mesimit mund te sherbeje edhe per aktivitete jashteshkollore rekreative te cilat afrojne komunitetin me Shkollen dhe me aktivitetet sportive. E gjithë sipërfaqja e brendshme e ish-palestres ka nevojë për rikonstruksion dhe rikonceptim. te saj ne nje mjedis multifunksional ku mund te zhvillohen aktivitetet sportive. Ne kete mjedis mungojne paisjet dhe infrastruktura e lehte per te bere te mundur zhvillimin e oreve mesimore sportive prandaj propozohet realizimi l ketij projekti l cili do te mundesoje zhvillimin e ketyre aktiviteteve brenda godines. Permes realizimit te ketij projekti synohet kompletimi l palestres me elementet e nevojshem per te kryer aktivitetet te mbyllura sportive, si tavolina ping pongu, hapsira dhe element per zhvillimin e aktiviteteve te gjimnastikes, etj, paisje qe sherbejne per zhvillimin e oreve sportive.


03. Kostot e Projektit te Investimit

Nderim i Ambienteve Sportive Shkolla "28 Nentori"			
Kostot e Projektit te Investimit/leke			
	Totali	Viti 2025	Viti 2026
Kosto e zbatimit	16,754,578	5,026,374	11,728,204
Kosto supervizim	273,109	273,109	
Kosto kolaudim	31,653	31,653	
Kosto totale e projektit – leke	17,059,340	5,331,136	11,728,204
Kostot e projektit te Investimit te miratuara per akordim nga MAS/leke			
	Totali	Viti 2025	Viti 2026
Kosto e zbatimit	12,565,933	2,513,187	10,052,746
Kosto supervizim			
Kosto kolaudim			
Kosto totale e projektit – leke			

	12,565,933	2,513,187	10,052,746
Kostot e Projektit te Investimit/ leke - Financim nga NJQV			
	Totali	Viti 2025	Viti 2026
Kosto e zbatimit	4,188,645	2,513,187	1,675,458
Kosto supervizim	273,109	273,109	
Kosto kolaudim	31,653	31,653	
Kosto totale e projektit – lekë	4,493,407	2,817,949	1,675,458

04.Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit Idesë</i>
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit(n.q.s ka) Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder Investimi do te realizohet: Faza e pare ne vitin 2025 ne shumen 5,331,136 leke Faza e dyte ne vitin 2026 ne shumen 11,728,204 leke Sekretari i Përgjithshëm Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (n.q.s. ka)				





Nr. 12	P.AF141.Q1.O2.A2 Rikonstruksion total i Pallatit të Sportit 'Qazim Dervishi'	AF141 Sport dhe Kulture
--------	--	--

01.Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	Firma e propozuesit te Projektit	
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit	dpmop@bashkiashkoder.gov.al		
Institucioni Buxhetor Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkodër	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02.Identifikimi i Idesë se Investimit

Projekt Idea	Rikonstruksion total i Pallatit të Sportit 'Qazim Dervishi'
Problemet për tu adresuar	Pallati i Sportit Qazim Dervishi është ndërtuar në vitin 1990 dhe përgjatë viteve nuk ka patur investime të mirëfillta për këtë objekt, por vetëm mirëmbajtje të zakonshme dhe riparime të vogla. Pallati i sportit shfrytëzohet kryesisht nga ekipet e sporteve me dorë, si basketbolli dhe volejboli, për zhvillimin e stërvitjeve gjatë gjithë vitit, si dhe për ndeshjet zyrtare. Ekipet stërviten çdo ditë përgjatë gjithë vitit nga ora 09:00 deri në 22:00, ndërsa gjatë fundjavës zhvillohen ndeshjet e kategorive të ndryshme të rritur, të rinj dhe para të rinj për meshkuj dhe femra, në disiplinat: volejboll, basketboll dhe futsal. Përveç këtyre aktiviteteve të përditshme, Pallati i Sportit shërben edhe si vend organizimi për kampionate kombëtare të zhvilluara nga federata të tjera sportive, si boksi, mundja, gjimnastika dhe xhudoja, të cilat zakonisht zgjasin 2–3 ditë dhe mbahen 1 ose 2 herë në vit. Krahas karakterit sportiv, objekti përdoret edhe për aktivitete të tjera të rëndësishme publike, si mitingje të mëdha të partive politike apo ceremoni institucionale, falë kapacitetit të tij të madh dhe kushteve të përshtatshme për evente me pjesëmarrje të gjerë. Kushtet aktuale ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë sportive por edhe në shëndetin e sportistëve të cilët ushtrojnë aktivitet
Emri i Programit	AF141 Kultura,Sporti,Argetim
Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti dote ndihmoje te arrihen	Programi synon të rrisë cilësinë, funksionalitetin dhe sigurinë e infrastrukturës sportive në Bashkinë Shkodër, duke përmirësuar standardet e ofrimit të shërbimeve sportive dhe duke krijuar kushte optimale për zhvillimin e aktiviteteve fizike, garave sportive dhe eventeve komunitare. Përmes rikonstruksionit të Pallatit të Sportit "Qazim Dervishi", programi kontribuon drejtpërdrejt në realizimin e prioritetëve të bashkisë për promovimin e aktivitetit fizik, rritjen e pjesëmarrjes në sport dhe pjesëmarrjen e ekipeve te qytetit në kompeticione ndërkombëtare me pallatin e sportit me parametrat e duhur. Në kuadër të këtij projekti, parashikohet një ndërhyrje e plotë rikonstruksioni, e cila do të përfshijë termoizolimin e godinës, rritjen e eficiencës energjetike përmes instalimit të dritareve të reja, përmirësimin dhe modernizimin e ambienteve të brendshme, si dhomat e zhveshjes, tualetet dhe zyrat e administratës. Gjithashtu, do të shtohen sistemet bashkëkohore të kondicionimit dhe ajrimit me ngrohje dhe ftohje, me qëllim krijimin e kushteve optimale për sportistët, publikun dhe përdoruesit e tjerë të objektit.

03. Kostot e Projektit te Investimit

Kosto Totale e Projektit leke	60,015,723
Kosto e zbatimit	57,000,000
Kosto e supervizim	893,508
Kosto Kolaudim	48,000
Kosto Projektim	2,074,215

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit Idesë</i>
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka) Institucioni Likuidues: Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike				
Sekretari i Pergjithshëm				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idesë
Komente nga Sekretari i Pergjithshëm (n.q.s. ka)				

Nr. 13	P.AF141.Q1.O2.A3 Ndertim i ambienteve sportive te Shkolles "Tring Smajli"	AF141 Sport dhe Kulture
--------	---	--

01.Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	Firma e propozuesit te Projektit	
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit	dpmop@bashkiashkoder.gov.al		
Institucioni Buxhetor Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkodër	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02.Identifikimi i Idesë se Investimit

Projekt Idea	Ndertim i ambienteve Sportive te Shkolles "Tring Smajli"
Problemet për tu adresuar	Shkolla "Tring Smajli" ka nje siperfaqe te sheshit prej 7000 m2 dhe aktualisht nuk mund te shfrytzohej per aktivite sportive per shkak te kushteve ne te cilat ndodhet. E gjithë siperfaqja e oborrit eshte e shtruar me beton duke mos ofruar kushte te mira per zhvillimin e aktiviteve sportive shkollore dhe jashte shkollore. Ne kete oborr te shkolles mungojne aksesoret per zhvillimin e aktiviteve sportive duke e bere te pamundur dhe te pashfrytzueshme te gjithë oborrin.
Emri i Programit	AF141 Kultura,Sporti,Argetim
Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti dote ndihmoje te arrihen	Rikualifikimi i ambienteve sportive ne Shkollen "Tring Smajli" do te jete ne funksion te nxenesve por edhe te rinjve te lagjes nr.3 duke krijuar nje mjedis te kendshem ne te cilin zhvillohen aktivite sportive. Rimodelimi i te gjithë sheshit,si para ndertesës,ashtu edhe prapa,e kthen kete shesh ne nje hapësire multifunksionale sportive dhe rekreative.Hapesirat sportive dhe rekreative do te mund te perdoren si nga nxenesit dhe mesuesit ashtu edhe nga i gjithë komuniteti ne territorin administrativ ku ndodhet shkolla. Permes realizimit te ketij projekti synohet ndertimi i 1 fushe te basketbollit,1 fushe per volejbol si dhe nje fushe kalceto me permasa 30m*17m me mbulese. Fushat e basketbollit dhe volejbollit do te jene te kompletuara me te gjitha aksesoret sipas standarteve me te mira duke shtruar edhe terrenet me material rezine qe e ben me te sigurte zhvillimin e aktivitetit sportiv. Gjithashtu do te realizohet edhe nje piste vrapimi me tartan.


03. Kostot e Projektit te Investimit

Tring Smajli Fushe Sportive			
Kostot e Projektit te Investimit/leke			
	Totali	Viti 2025	Viti 2026
Kosto e zbatimit	53,376,813	16,013,044	37,363,769
Kosto supervizim	1,121,072	1,121,072	
Kosto kolaudim	48,000	48,000	
Kosto totale e projektit – lekë	54,545,885	17,182,116	37,363,769
Kostot e projektit te Investimit te miratuara per akordim nga MAS/leke			
	Totali	Viti 2025	Viti 2026
Kosto e zbatimit	40,032,610	8,006,522	32,026,088
Kosto supervizim			
Kosto kolaudim			
Kosto totale e projektit – lekë	40,032,610	8,006,522	32,026,088
Kostot e Projektit te Investimit/ leke - Financim nga NJQV			

	Totali	Viti 2025	Viti 2026
Kosto e zbatimit	13,344,203	8,006,522	5,337,681
Kosto supervizim	1,121,072	1,121,072	
Kosto kolaudim	48,000	48,000	
Kosto totale e projektit – lekë	14,513,275	9,175,594	5,337,681

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit Idesë</i>
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit(n.q.s ka) Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder Investimi do te realizohet: Faza e pare ne vitin 2025 ne shumen 17,182,116 leke Faza e dyte ne vitin 2026 ne shumen 37,363,769 leke				
Sekretari i Përgjithshëm				
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (n.q.s. ka)				



Nr. 14	P.AF141.Q1.O12.A4 Projektim rikonstruksione fusha sportive	AF141 Sport dhe Kulture
--------	---	----------------------------

01.Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	Firma e propozuesit te Projektit	
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit	dpmop@bashkiashkoder.gov.al		
Institucioni Buxhetor Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkodër	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02.Identifikimi i Idesë se Investimit

Projekt Idea	Projektim rikonstruksion fusha sportive
Problemet për tu adresuar	Bashkia e konsideron me rëndësi parësore hartimin e projekteve cilësore për fushat sportive, pasi mungesa e tyre pengon sigurimin e fondeve dhe vonon investimet në infrastruktura që janë thelbësore për komunitetin. Shumë zona kanë nevojë urgjente për terrene të rregulluara, rinovim të hapësirave ekzistuese dhe krijimin e ambienteve të reja sportive, por pa dokumentacion të plotë teknik, mundësitë për financim humben. Duke qenë se aktiviteti fizik dhe sporti luajnë një rol të rëndësishëm në shëndetin publik, zhvillimin e të rinjve dhe përfshirjen sociale, krijimi i hapësirave të sigurta dhe funksionale është domosdoshëm. Prandaj, përgatitja e projekteve të standardizuara për fushat sportive është kusht kyç për të përfituar fonde dhe për t'i ofruar komunitetit mundësi më të mira për aktivitet fizik, rekreacion dhe zhvillim të shëndetshëm.
Emri i Programit	AF141 Kultura,Sporti,Argetim
Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti dote ndihmoje te arrihen	Qëllimi kryesor është përmirësimi i infrastruktures sportive në territorin e bashkisë, në mënyrë që komuniteti të ketë akses në hapësira të sigurta, funksionale dhe të përshtatshme për aktivitet fizik. Përmes hartimit të projekteve të plota dhe cilësore synohet sigurimi i fondeve të nevojshme për ndërtimin, rikonstruksionin dhe modernizimin e fushave sportive. Objekti është krijimi i kushteve që nxisin një mënyrë jetese më të shëndetshme, mbështesin zhvillimin fizik e social të të rinjve, dhe rrisin përfshirjen e qytetarëve në aktivitete sportive e rekreative. Përgatitja e dokumentacionit teknik të standardizuar do të mundësojë realizimin e investimeve të qëndrueshme që i shërbejnë gjithë komunitetit.

03. Kostot e Projektit te Investimit

Kosto Totale e Projektit leke	10 000 000
Kosto e zbatimit	
Kosto e supervizim	
Kosto Kolaudim	
Kosto Projektim	10 000 000

04.Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit Idesë</i>
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit(n.q.s ka) Institucioni Likuidues: Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike				
Sekretari i Përgjithshëm				
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (n.q.s. ka)				

Nr.15	P.AF141.Q2.O1.A1 Paga dhe sigurime shoqerore i objekteve të trashëgimisë së kulturës (Muze+biblioteka+galeria)	AF141 Sport dhe Kulture					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
Situata							
Çdo aktivitet artistik që ndërmerret është në bashkëpunim dhe me miratim të administratës së bashkisë dhe strukturave të saj. Strukturat e Trashëgimise Kulturore si: Bibloteka Publike “Marin Barleti” Muzeu Historik : Muzeu “Oso Kuka”, Vendin e Dëshmise dhe Kujteses, Muzeu i Kalasë “Rozafa” Galeria e Arteve. Bashkeveprojne per organizimin e aktiviteteve promovuese dhe studimore te trashëgimise sone. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Përvetëqeverisjenvendore” i ndryshuar ; Udhëzimit nr.2, date 02.04.2025, «Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028; dhe buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2026; VKM nr. 113 dt.01.03.2023 “Përpërcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” ; VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 “Përmiratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjerambipagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa nstitucione të administratëspublike” ; VKM nr. 326 datë 31.05.2023 “Përpagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike” ; VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 “Përklasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjesvendore, përefekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësvecivilë e të punonjësveadministrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” VKB nr 54 date 30.09.24 “Per miratimin e nivelit te pagave te funksionareve te zgjedhur ose te emeruar te nepunesve civile e te punonjesve administrative te bashkise Shkoder dhe institucioneve te varesise, i ndryshuar. Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, datë 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.							
ii. Synimi i projektit							
Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore, edukuese për komunitetin. Qasja ndaj përvojave bashkëkohore të lidhura me akumulimin, sistemin, administrimin dhe vënien në përdorim të informacionit për përdoruesin, Normaliteti në ecurinë e punëve të përditshme,							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
Përcaktimi i prioriteteve në mbarëvajtjen e punës. Përcaktimi i materialeve më të domosdoshme për të realizuar aktivitetet. Përcaktimi i i shpenzimeve për paga dhe sigurimet për punonjësit dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme për strukturat							
b) Rezultatet që prisni							
Krijimi i mundësive të reja për qasje në rrjete të integruara ndërkombëtare. Normalitetit në përditshmërinë e aktivitetit të Institucioneve të Degës Ekonomike të Kulturës							
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt				
Institucionet dhe punonjësit përkatës të Publiku qytetar			Bashkia Shkodër.				
e) Shpenzimet e llogaritura							
		Totali	Nga kjo:				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	18,232	18,232				
A.2	Sigurime Shoqërore	2,900		2,900			
	Shuma	21,132	18,232	2,900			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	18,232	18,232				

A.2	Sigurime Shoqërore	2,900		2,900			
	Shuma	21,132	18,232	2,900			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga	18,232	18,232				
A.2	Sigurime Shoqërore	2,900		2,900			
	Shuma	21,132	18,232	2,900			
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Gjatë vitit 2026		Drejtoria e Kulturës dhe Sportit					
Gjatë vitit 2027							
Gjatë vitit 2028		Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder					

Nr.16	P.AF141.Q2.O1.A2	AF141 Sport dhe Kulture				
	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Objektet e trashëgimisë kulturore funksionojnë në 6 ndërtesa, të cilat kërkojnë mirëmbajtje dhe pastrim të vazhdueshëm. Mbarëvajtja e punës në këto objekte, kërkon edhe kushtet e nevojshme në ambientet tyre. Duke qenë se strukturat tona frekuentohen nga një publik i gjerë, na lind detyrimi t'i paraprijmë çdo lloj pakujdesie që do të shkaktonte ndonjë shkëndijë zjarri. Pajisja me fikëse zjarri e objekteve të cilët posedojnë vepra arti është gjithashtu një detyrim ligjor, i cili përmbushet cdo vit, me rimbushjen dhe kolaudimin e bombulave ekzistuese. Kujdesi për parandalimin e dëmtimeve të inventarit fizik dhe të koleksioneve të ndryshme nga një sërë faktorësh natyrorë është një objektivi i përhershëm i punës. Çdo vit realizohet kontrata me shoqëri të sigurimit për siguracion të ndërtesës, si mundësi e minimizimit të humbjeve në rastet e fatkeqësive natyrore dhe zjarrit. Muzeu Historik Shkodër ka disa godina në administrim sic janë: Muzeu “Oso Kuka”, “Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës” (VDK) dhe Muzeu i Kështjellës, janë elementë arkitektonikë të rëndësishëm, të cilët kanë lidhje të drejtpërdrejtë. Për vitin 2025 në Muzeun Historik është bërë ndërhyrje në portën kryesore si dhe është pastruar dhe lyer fasada e ndërtesës. Për vitin 2026 parashikojmë restaurimin e plotë të sallës së pinakotekës, parket, riparim dhe lyerje muri, hidroizolim dhe riparim e shtim i kamerave, pikërisht tek pinakoteka dhe fondi etnografik. Pastrim dhe restaurim i dyshemesë së magazinës së arkeologjisë si dhe riparim i rrjetit elektrik brenda sektorit të arkelogjisë dhe jashtë rreth e rrotull objektit të muzeut. Gjithashtu duhet ndërhyrje emergjente në çatinë e ndërtesës për të realizuar restaurimin e plotë të saj. Nevojiten kamera për çdo dhomë, dhe ambjent të muzeut. Kontroll dhe mirëmbajtje të kabllove të ndriçimit dhe pajisjeve të sigurisë. Lyerje me vaj liri të sipërfaqeve prej druri si dhe lyerje me anti ruzhë të sipërfaqeve prej metali (dyer, parmakë, dritare etj), lyerje me gëlqere të sipërfaqeve të brendshme te muzeut. Në Muzeun e Kështjellës për vitin 2025 nuk është zhvilluar akoma ndërhyrja e kërkuar , ndërsa për vitin 2026 parshikojmë mirëmbajtje të pjesës së brëndshme, lyerje me gëlqere, lyerje me vaj liri të sipërfaqeve prej druri si dhe lyerje me anti ruzhë të sipërfaqeve prej metali (dyer, parmakë, dritare etj). Gjithashtu duhet ndërhyrje emergjente dhe e specializuar për disa pajisje kinematografike kamera etj, të cilat janë të ekspozuara jashtë në një anë të muzeut nën ndikimin negativ të agentëve atmosferikë, është e nevojshme të pastrohen dhe të konservohen, të mbrohen nga faktorët atmosferikë, me një mbulesë transparente p.sh. xham i fortë apo diçka tjetër reziztente, sepse mund të jenë një atraksion i shtuar për vizitorët. Pajisje për ruajtjen dhe ekspozimin e objekteve të vecanta, si vitrina me qelq të fortë, ekspozue etj. 100 lampa LED lloje të ndryshme sipas ekspozitave të Muzeut Historik Shkodër. 100 lampa LED lloje të ndryshme për Muzeun e Kështjellës. 10 prozhektorë. Dezinfektantë për insketet në ambientete e brendshme dhe në fondet muzeore si bar tenj Në aspektin e mirëmbajtjes së ambienteve: në vitet e shkuara janë realizuar në mënyrë të pjesshme hidroizolimi i tarracës së Bibliotekës “Marin Barleti”, lyerja e ambienteve të brendshme të korridoreve dhe një pjesë e sallave, si dhe rehabilitimi i sistemit elektrik dhe mirëmbajtja dhe zëvendësimi i vetratave dhe dritaret. Vitet në vijim është menduar që të vazhdohet hidroizolimi i pjesës së galerisë dhe disa ndërhyrje teknike, duke pasur parasysh gjendjen e amortizuar të ndërtesës, ku problematikat më të mëdha shfaqen gjatë stinës së dimrit. Gjithashtu Salla ekspozuese e Galerisë së Arteve, e cila shtrihet në një hapësirë mbi 200 m², ndahet në 3 hapësira pak a shumë të barabarta, të cilat kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme. Kjo situatë është komentuar nga publiku dhe artistët si jashtë standarteve dhe ndikon në statusin e vetë galerisë.						
ii. Synimi i projektit						
Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore, edukuese për komunitetin. Qasja ndaj përvojave bashkëkohore të lidhura me akumulimin, sisteminim, administrimin dhe vënien në përdorim të informacionit për përdoruesin, përmes hostimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të katalogimit elektronik Rritja e sigurisë në institucionet e kulturës dhe e frekuentuesve të këtyre institucioneve. Normaliteti në ecurinë e punëve të përditshme, si dhe ruajtja e personelit dhe e përdoruesve të bibliotekës.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Përcaktimi i prioriteve në mbarëvajtjen e punës. Përcaktimi i materialeve më të domosdoshme për të realizuar aktivitetet. Përcaktimi i i shpenzimeve për paga dhe sigurimet për punonjësit Kulturës dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme për institucionet e kulturës						
b) Rezultatet që prisni						
Krijimi i mundësive të reja për qasje në rrjete të integruara ndërkombëtare. Normalitetit në përditshmërinë e aktivitetit të Institucioneve të Kulturës Rritja e sigurisë						
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt				
Institucionet dhe punonjësit përkatës Publiku qytetar		Bashkia Shkodër.				
e) Shpenzimet e llogaritura						
	Totali	Nga kjo:				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026	(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale

A.1	Materiale pastrimi /sanitare	60			60		
A.2	Energji elektrike	850			850		
A.3	Ujë	250			250		
A.4	Shërbim Interneti dhe Telefonie	140			140		
A.5	Mirëmbajtje objekteve të trashëgimisë kulturore	2,260			2,260		
A.6	Siguracion ndërtese	160			160		
A.7	Rimbushje Fikëse Zjarri	150			150		
A.8	Shërbimi i sigurise	1749			1749		
	Shuma	5,619			5,619		
		Totali	Nga kjo:				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime të ndryshme operative	5,619			5,619		
	Shuma	5,619			5,619		
		Totali	Nga kjo:				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime të ndryshme operative	5,619			5,619		
	Shuma	5,619			5,619		
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Gjatë vitit 2026		Drejtoria e Përgjithshme Kulturës, dhe Sportit					
Gjatë vitit 2027		Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike					
Gjatë vitit 2028		Institucioni Likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike					

Nr.17	P.AF141.Q2.O1.A3 Shpenzime materiale dhe pajisje per funksionimin e objekteve te trashegimise kulturore	AF141 Sport dhe Kulture
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Drejtorja e Kultures ka në strukturat e saj struktura te trashegimise kulturore që ushtrojnë funksionet në 6 ndërtesa të cilat kërkojnë mbështetje financiare te vazhdueshme per funksionimin e tyre, realizimin e aktiviteteve te parashikuara si dhe mirëmbajtje te tyre. Aparat alarmi per insektet (Pest monitoring Kit) posaçerisht per muzete me nje vlere rreth 20 mije leke. Blerje e veglave të punës (shkallë e palosshme 3m, gërhërë krasitëse, mistri, lopatë, rrëshqel, fshehtë e ashpër për pastrimin e gjetheve si dhe 10 koka sperkatese uji qe ngulen ne toke dhe labin barin) me nje vlere rreth 20 mije leke. Në veprimtarinë e përditshme të punojësve, nevojiten pajisje kancelarike, sipas profileve të secilit pozicion të punës, dhe parashikohet nje buxhet prej 95 mije leke. Mbarëvajtja e punës në këto institucione, kërkon edhe kushtet e nevojshme në ambjentet e këtyre institucioneve, pajisje zyre (Inventar ekonomik), te cilat jane konsumuar gjate viteve apo kane dale jashte perdorimit, si prsh në Muzeun Historik të Shkodrës po zhvillohen shumë aktivitete dhe është e nevojshme të pajisemi me 30 karrige plastike. nevojiten 2 fshesa me korrent gjithashtu 3 karrige zyre, kurse në Muzeun e Kështjellës nevojiten 2 karrige zyre. Te gjitha keto parashikojne nje buxhet prej 276 mije leke		
Duke patur parasysh normën e lartë të amortizimit të pajisjeve TIK, është i nevojshëm plotësimi me kompjutera të rinj dhe pajisje te tjera TIK për punonjësit e trashegimise kulturore . Gjithashtu në muze është një ekran/tv i cili nuk funksionon dhe ka foto të dixhitalizuara të fondit të etnografisë. Kërkojmë që të rregullohet dhe të jetë i aksesueshëm për turistët.. (të kërkuara që nga Buxheti 2025) .Muzeun Historik të Shkodrës po zhvillohen shumë aktivitete dhe është e nevojshme të pajisemi me qendër zëri (boks dhe mikrofon) dhe 1 Printer. Për mbarëvajtjen e punës në Muzeun e Kështjellës nevojiten 2 deumifikatorë dhe 1 Laptop. Vlera e parashikuar per ta eshte rreth 166 mije per elektroniken dhe 50 mije per deumifikatore.		
Gjithashtu, planifikohet prodhimi i biletave per vizitoret , me të gjithë parametrat ligjor dhe informues, përveç informacionit bazë si: çmimi dhe destinacioni, edhe të dhëna mbi faqen zyrtare web të Muzeut Historik Shkodër. Biletat jane te ndara ne 3 kategori dhe cmime respektive ,sipas paketes fiskale te miratuar me Vendim Keshillit Bashkiak ne perputhje me VKM nr 1497 dt 19/ 11 /2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë" , I ndryshuar .Vlera e parashikuar per keto shpenzime eshte rreth 200 mije leke. Nga ana tjeter ne Biblioteken "Marin Barleti" nevojiten materiale kancelarike me nje buxhet te parashikuar prej 93 mije leke. Eshte e domosdoshme pajisja me 1 kompjuter Workstation Advanced (Sipas Prodhuesit), 1 Router Wireless Wi-Fi dhe 1 laptop ne kuader dhe te projektit per digjitalizimin e bibliotekes. Keto pajisje llogariten me nje buxhet prej 580 mije leke. Për të ruajtur materialet, për të krijuar kushte të mira për përdoruesit dhe për stafin e bibliotekës, është domosdoshmëri të trajtohen mirë kushtet klimatike në ambientet ku qëndrojnë librat dhe përdoruesit. Nga informacionet publike, nuk ka të dhëna të detajuara për sistemin aktual të ftohjes dhe ventilimit në bibliotekë, por duke marrë parasysh volumet, llojin e shërbimit (bibliotekë publike me mjedise studimi dhe arkivimi) dhe moshën e ndërtesës, ka gjasa që sistemet ekzistuese nuk plotësojnë standartet optimale për ftohje, de-humidifikim dhe ruajtje klimatike. Një ambient me lagështi të lartë ose ventilim të pamjaftueshëm mund të rrisë rrezikun për fondin. Kondicionerët dhe deumifikatorët janë pjesë thelbësore e sistemit klimatizues që ruan integritetin e fondit. Ne galerine e Arteve nevojitet baze materiale kancelarike prej 90 mije lekesh.		
ii. Synimi i projektit		
Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore, edukuese për komunitetin. Qasja ndaj përvojave bashkëkohore të lidhura me akumulimin, sistemin, administrimin dhe vënien në përdorim të informacionit për përdoruesin përmes hostimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të katalogimit elektronik Rritja e sigurisë në institucionet e kulturës dhe e frekuentuesve të këtyre institucioneve. Normaliteti në ecurinë e punëve të përditshme, si dhe ruajtja e personelit dhe e vizitorëve. Më shumë pastërti. Ndricim i përshtatshëm për ekspozitat e përhershme		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Përcaktimi i prioriteteve në mbarëvajtjen e punës. Përcaktimi i materialeve më të domosdoshme për të realizuar aktivitetet. Përcaktimi i shpenzimeve të nevojshme për institucionet e trashegimise kulturore. Përpilimi i specifikimeve teknike të biletës, e cila është një masë me vlerë e miratuar (çmimi i biletës) me VKB, sipas ligjit për Muzetë. Plotësim i nevojave kompjuterike dhe një teknologji më të avancuar Deumodifikator që përmirësojnë përqindjen e lagështirës		
b) Rezultatet që prisni		

Krijimi i mundësive të reja për qasje në rrjete të integruara ndërkombëtare.										
Normaliteti në përditshmërinë e aktivitetit të Institucioneve të trashëgimise kulturore.										
Rritja e standarteve dhe cilesise se aktiviteve dhe veprimtarise.										
Shtimi i fluksit të vizitorëve,										
Rritja e sigurisë										
Rritja e arkëtimeve,										
Tërheqja e vëmendjes turistike.										
Përmirësim i performancës në punë dhe ruajtje e trashëgimisë kulturore										
Krijim i kushteve te favorshme dhe per punonjesit e institucioneve te trashëgimise kulturore.										
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt						
Strukturat e trashëgimise kulturoe dhe punonjësit përkatës Publiku				Bashkia Shkodër.						
e) Shpenzimet e llogaritura										
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026				Totali		Nga kjo:				
				(mijë lekë)		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime materiale kancelarike			278				278		
A.2	Blerje paisje TIK(pajisje elektronike)			746						746
A.3	Prodhim dhe shtypje biletash			200				200		
A.4	Inventar ekonomik(mobilje zyre)			252						252
A.5	Blerje deumidifikatore dhe kondicioner Biblioteka			430						430
A.6	Blerje fsheze me korrent			24						24
A.7	Pest monitoring kit			20						20
A.8	Blerje vegla pune			20						20
	Shuma			1,970				478		1,492
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027				Totali		Nga kjo:				
				(mijë lekë)		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime per funksionimin e objekteve te trashëgimise kulturore			1970				720		1250
	Shuma			1970				720		1250
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028				Totali (mijë lekë)		Nga kjo:				
						Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime të ndryshme operative			2,700				1,000		1,700
	Shuma			2,700				1,000		1,700
f) Periudha e zbatimit				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:						
Gjatë vitit 2026				Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës						
Gjatë vitit 2027				Biblioteka “Marin Barleti”						
Gjatë vitit 2028				Drejtoria e Pergjithshme Kulturës dhe Sportit Drejtoria e Kultures						
				Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder						

Nr 18	P.AF141.Q2.O1.A4 Realizimi i aktiviteteve te trashegimise kulturore.	AF141 Sport dhe Kulture
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Strukturat e trashegimise kulturore organizojne nje sere aktiviteteve gjate vitit.Për vitin 2026 parashikojmë një shumëllojshmëri aktiviteteve në kuadër të ditëve ndërkombëtare dhe jo vetëm,të cilat janë me rëndësi për ngjarjet e zhvilluara në Shkodër por edhe për prezencën e tyre në historinë tonë kombëtare.		
-Dita Ndërkombëtare e Trashëgimisë Kulturore dhe siteve parashikojmë të organizojmë aktivitet me shkollat 9 vjecare të qytetit. Ekspozitë me punimet e fëmijëve të udhëhequr nga dy mësuese, punimet do jenë pikturë, vizatim me fokus Trashëgimia kulturore e qytetit.		
Honorare 2 x 10.000= 20.000 leke Poster 2.500		
-Dita Ndërkombëtare e Muzeve zhvillohet çdo vit më 18 Maj. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me institucionet e kulturës dhe partnere të tretë , me datat 17 dhe 18 maj kanë zhvilluar një serë aktiviteteve për qytetarët. Për vitin 2025 u organizua aktiviteti “Pikturojmë trashëgiminë” ku fëmijë nga mosha 7 deri në 12 vjeç pikturuan objekte të ndryshme të ekspozuara në muze. Ky aktivitet shërben që fëmijët përmes pikturës të lidhen më tepër me trashëgiminë tonë kulturore. Për vitin 2026 në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve parashikojmë të organizojmë ekspozitë me piktura nga piktorja Erëmirë Jahja. Per kete aktivitet eshte planifikuar shpenzime :		
Honorare STUDIUES I 15000 leke Poster 2.500 leke		
-Festat e Nëntorit 28-29 Nëntor 28-29 nëntor për vitin 2025 do të zhvillohet ekspozita me jelekë nga fondi etnografik i muzeut. Ndërsa për vitin 2026 planifikojmë një aktivitet rreth xhubletës, sfilatë, këngë, valle.		
Honorare ARTISTI I 15.000 leke Honorare ARTISTI II 15.000 leke POSTER 2.500 leke PRITJE PERCJELLJE 20.000 leke		
-Ekspozita me objekte të paekspozuara të fondit të arkeologjisë në kuadër të Ditëve të Trashëgimisë. Honorare KURATOR 15.000 leke PRINTIME FOTO FOREX A3 15.000 leke POSTER 2.500 leke		
-Aktivitet në bashkëpunim me COD i cili përfshin punëtori në muajt shkurt,mars, prill dhe në fund ekspozita me punimet e fëmijëve. POSTER 2.500 leke Honorare PIKTOR 15.000 leke		
-Ekspozitë lëvizëse me foto të qytetit ndër vite. Honorare KURATOR 15.000 leke POSTER 2.500 leke		
-Trajtime nga stafi i muzeut për nxënësit e shkollave.		
-Aktivitete në kuadër të muajit të letërsisë. Honorare STUDIUES I 15.000 leke Honorare STUDIUES II 15.000 leke POSTER 2.500 leke		
-Aktivitet në kuadër të 165 vjetorit të vdekjes së Oso Kukës. Seminar shkencor me referime nga studiues, historianë dhe studentë. Honorare 3x 10.000 30.000 leke PRITJE PERCJELLJE 20.000 leke POSTER 2.500 leke		
Projekti Jubilar “95-vjetori i Bibliotekës Publike ‘Marin Barleti’” Në vitin e saj të 95-të, Biblioteka Publike “Marin Barleti” shënon një moment të rëndësishëm në historinë kulturore të Shkodrës dhe të gjithë hapësirës shqiptare. Me gati një shekull në shërbim të lexuesit, institucioni hap dyert për një program të zgjeruar festimesh, që synon të pasqyrojë jo vetëm rrugëtimin e bibliotekës, por edhe rolin e saj si qendër e dijes, kujtesës dhe kreativitetit qytetar. Programi jubilar është konceptuar si një mozaik veprimtarish që ndërtojnë urën mes traditës dhe të ardhmes. Panelet e diskutimit do të sjellin së bashku studiues, shkrimtarë, përkthyes, bibliotekarë dhe personalitete të kulturës për të trajtuar tema që lidhen me evoluimin e librave, sfidat e lexueshmërisë, rolin e bibliotekave publike në epokën digjitale, si dhe trashëgiminë letrare të Shkodrës. Këto biseda synojnë të hapin horizonte të reja mendimi dhe të ofrojnë reflektime të thelluara mbi misionin e bibliotekës në shoqërinë		

bashkëkohore.

Krahas tyre, projekti përfshin një seri **workshopesh** të dedikuara për fëmijë, të rinj dhe të rritur: nga udhëzimet në shkrim krijues, promovimi i kulturës së leximit dhe mjetet e kërkimit bibliografik, deri tek format inovative të përdorimit të arkivave dhe koleksioneve të bibliotekës. Këto sesione synojnë të nxisin pjesëmarrjen aktive të komunitetit dhe të sjellin më pranë publikut shërbimet bashkëkohore të bibliotekës.

Në kuadër të festimeve do të çelet edhe një sërë **ekspozitash tematike**: ekspozita dokumentare mbi historinë e 95 viteve të bibliotekës; ekspozita të librit të rrallë dhe fondit të trashëgimisë; ekspozita fotografike që pasqyrojnë jetën kulturore të qytetit; si dhe instalacione artistike të krijuara posaçërisht për këtë edicion jubilar. Nëpërmjet tyre, vizitorët do të kenë mundësinë të shohin nga afër rrugëtimin e institucionit nga themelimi deri sot.

Projekti "95-vjetori i Bibliotekës Publike 'Marin Barleti'" nuk është thjesht një përkujtim simbolik; ai është një ftesë për të riimagjinuar rolin e bibliotekës si hapësirë e përbashkët kulturore, edukative dhe komunitare. Përmes aktiviteteve të saj, biblioteka synon të forcojë marrëdhëniet me lexuesit, të nxisë dialogun intelektual dhe të krijojë një traditë të re bashkëkohore për brezat që vijnë.

Per kete aktivitate parshikohen nje buxhet prej 176 mije leke ku perfshin :akomodim/trajtim ushqimor 66 mije leke,shpenzime promocioni 10 mije leke,Honorare per te ftuar (3 persona *15000 dhe 2* 10000) 65 mije leke.

Projekti "Muzat" – Gratë që krijojnë

Me datë 18 Maj në oborrin e brendshëm të Biblioteka Publike "Marin Barleti", hapur pas më shumë se 50 vitesh, u organizua aktiviteti për "Muzat". Një aktivitet dedikuar totalisht figurë së gruas, nëpërmjet poezisë dhe pikturës. **"Muzat"** është një projekt artistik dhe kulturor që vendos në qendër figurën e gruas si krijuese, inspiruese dhe interpretuese. Ngjarja mbledh së bashku **gra artiste**, piktores, performuese, poete, muzikante dhe interpretuese të formave të ndryshme të artit, për të sjellë një program multidisiplinor që flet për zërat, historitë, ndjeshmëritë dhe fuqinë krijuese të grave.

Projekti synon të ndërtojë një hapësirë ku arti i grave të jetë i dukshëm, i vlerësuar dhe i vënë në dialog ndër-gjeneracional. "Muzat" është një festë e talentit dhe prurjeve të tyre, por edhe një reflektim mbi rolet, sfidat dhe kontributin e grave në art e kulturë. Përmes ekspozitave, performancave, leximeve artistike, instalacioneve, muzikës live, diskutimeve dhe ndërveprimeve me publikun, "Muzat" krijon një platformë të gjallë për të afirmuar jo vetëm artin që prodhohet gratë, por edhe përvojën e tyre njerëzore e shoqërore.

Projekti i jep zë gruas në të gjitha format e saj: si artiste, si krijuese, si trup interpretuar, si figurë frymëzuese, si qenie që i jep botës ngjyrë, ritëm e kuptim. Per kete aktivitet parshikohet nje buxhet prej 76.4 mije leke ne total ku perfshijne:shpenzime AKomodimi dhe trajtim ushimor 26.4 mije leke,shoenzime promocioni 10 mije leke dhe honorare per te ftuar (2persona*10000) 20 mije leke.

Festimi i 115-vjetorit të lindjes së Millosh Gjergj Nikolla – Migjeni

Ky projekt ka për qëllim të nderojë jetën dhe krijimtarinë e një prej figurave më të rëndësishme të letërsisë shqipe, poetit Millosh Gjergj Nikolla, i njohur me pseudonimin **Migjeni**, në 115-vjetorin e lindjes së tij. Ngjarja synon të rikthejë në vëmendje veprën e tij letrare, ndikimin e tij në letërsinë moderne shqiptare dhe mesazhet e përhershme të poezisë dhe prozës së tij. Ky projekt parashikon një buxhet prej 35 mije lekesh ku perfshin:shpenzime promocioni 10 mije leke dhe honorare per 1 te ftuar 15 mije leke dhe 1 moderator 10 mije leke.

"Poezi n'Fest" – Dita Ndërkombëtare e Poezisë

"Poezi n'Fest" është një aktivitet festiv dhe kulturor i dedikuar kremtimit të **Ditës Ndërkombëtare të Poezisë** më 21 mars. Kjo ngjarje kulturore planifikon të përfshijë autorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Projekti synon ta kthejë poezinë në një përjetim të gjallë, kolektiv dhe të përbashkët, duke e nxjerrë nga faqet e librit dhe duke e sjellë në hapësirat publike të qytetit. Ngjarja përmblendh një sërë aktivitete poetike që ndërthurin lexime, performanca, muzikë, art vizual dhe pjesëmarrje komunitare. "Poezi n'Fest" vendos në qendër krijuesit bashkëkohorë, poetët e rinj dhe zërat e rinj të letërsisë, duke hapur një hapësirë të lirë komunikimi mes poetit dhe publikut. Nëpërmjet leximeve të hapura, mikroskeneve poetike, aktivitetit "poezi në rrugë", punëtorive krijuese, takimeve me autorë dhe instalacioneve me vargje të vendosura në hapësira publike, projekti synon të nxisë dashurinë për poezinë dhe të sjellë një qasje më të afërt, të gjallë dhe bashkëkohore ndaj saj. "Poezi n'Fest" është një festë e fjalës së shkruar dhe e zërit poetik, një takim i përvitshëm i komunitetit me letërsinë, ku poezia bëhet ritual qytetar dhe përvojë e përbashkët kulturore.

Me datë 22 Mars, në natën e dytë të këtij festivali gjithashtu jepen 2 çmime, njëri për poetin e karrierës dhe tjetri për poetin e ri. Organizimi i veprimtarive kulturore është pjesë e pandarë e veprimtarive të bibliotekave, sidomos atyre publike, të cilat në ditët e sotme nuk janë thjesht vende të kërkimeve shkencore, por ata përpiqen të gjejnë forma dhe mënyra të reja për të ndikuar në jetën intelektuale, kulturore dhe shoqërore të njerëzve. Forumet dhe bisedat aktivitet kulturore, që në bibliotekën tonë zhvillohen prej shumë vitesh. Këto forume dhe biseda kanë lindur nga kërkesa dhe nevoja e vetë qytetarëve. Këto forume dhe biseda kanë si qëllim trajtimin dhe diskutimin e çështjeve të ndryshme tëaspektit kulturor që kanë të bëjnë me librin, dijen, letërsinë, historinë, përthimin etj. Ideja e krijimit të këtij aktiviteti është për të bërë të mundur kontaktin e drejtpërdrejtë të studiuesve, krijuesve, historianëve, përkthyesve me lexuesit dhe personat e interesuar. Per kete aktivitet janë planifikuar shpenzime prej 235.6 mije leke ne total ku perfshihen :akomodim dhe trajtim ushqimor 104.6 mije leke,shpenzime promocioni 10 mije leke dhe honorare per te ftuar (6 persona *10000) 60 mije leke.

Aktivite letrare per Femije Letërsia për fëmijë është një ndër zhanret më të veçanta të letërsisë. Vitet e fundit ajo është zbehur shumë dhe ka mungesë të theksuar të shkrimtarëve që e lëvrojnë këtë zhanër. Në qytetin e Shkodrës ka shumë të rinj dhe të reja të cilët lëvrojnë gjini të ndryshme të letërsisë.

Në kuadër të promovimit të leximit, krijimtarisë dhe edukimit letrar të fëmijët, për vitin 2026 do të organizohen **gjashtë aktivitete kryesore** gjatë periudhave të ndryshme të vitit. Çdo aktivitet do të ketë si të ftuar persona të shquar në fushën e letërsisë për fëmijë, duke përfshirë:

Pedagogë të fushës së letërsisë dhe edukimit letrar për fëmijë, të cilët do të ndajnë njohuritë e tyre dhe metoda inovative për lexueshmërinë.

Njohës të letërsisë për fëmijë, studiues ose kritikanë që do të ofrojnë prezantime mbi rëndësinë e leximit dhe vlerësimin e veprave letrare për fëmijë.

Përkthyes të letërsisë për fëmijë, të cilët do të sjellin perspektiva ndërkombëtare dhe do të prezantojnë libra të përkthyer me ndikim edukativ dhe kulturor.

Autore të letërsisë për fëmijë, të cilat do të ndajnë eksperiencat e tyre krijuese dhe do të lexojnë pjesë nga veprat e tyre.

Shkrimtarë të letërsisë për fëmijë, të cilët do të udhëheqin workshop-e krijuese dhe do të nxisin pjesëmarrjen aktive të fëmijëve.

Qëllimi i këtij propozimi është nxitja e fëmijëve drejt librit dhe bibliotekës si tempull i librit. Aktiviteti do të zhvillohet në Bibliotekën «Marin Barleti», i ndarë në disa muaj, në formën e workshop-eve të ofruara falas për fëmijë nga mosha 5-12 vjeç. Aktiviteti do të realizohet në bashkëpunim me të gjithë parashikollorët dhe shkollat nëntëvjeçare të territorit të Bashkisë Shkodër dhe autorëve të cilët

e shkruajnë dhe e zhvillojnë letersinë për fëmijë. Për këto aktivitete është planifikuar shpenzime për honorare 65 mijë leke(4*10000 dhe 1*15000)						
LISTA E HONRAREVE HONORARE STUDIUES I(I,II,III,IV) 15 mijë leke HONORARE TE FTUAR I 10 mijë leke HONORARE TE FTUAR II 15 mijë leke HONORARE TE FTUAR III 20 mijë leke HONORARE ARTISTI I 15 mijë leke HONORARE ARTISTI II 15 mijë leke HONORAR KURATOR 15 mijë leke HONORAR PIKTOR 15 mijë leke						
ii. Synimi i projektit Aktivitetet e institucioneve të trashëgimisë kulturore synojnë bashkëveprimin dhe bashkërendimin e synimeve të secilit institucion me qëllimin e përbashkët të krijimit të një klime bashkëpunimi në mënyrë që t'i vijë në ndihmë institucioneve studimore, personave të interesuar, studiuesve apo kërkuesve shkencorë sa i përket studimeve apo interesave të ndryshme kulturore në të mirë të njohjes së të shkuarës, si dhe formësimit të Kujtesës si një strukturë e formësuar dhe solide. Organizimi i aktiviteteve që kanë si qëllim perkujtimin e diteve nderkombetare. Rivitalizimi i vlerave materiale dhe shpirtërore të dispozitivit të administruar nga sistemi i muzeve Shkodër. Promovimi i figurave historike të qytetit. Krijimi i një hapësire për refektim dhe dialog. Nxitja e të rinjve përmes ekspozitave të muzeut që të kuptojnë dhe vlerësojnë historinë dhe kulturën e tyre kjo, përfshin programe arsimore, vizita të udhëhequra dhe aktivitete interaktive për shkollat dhe universitetet. Të valorizojë historinë 95-vjeçare të Bibliotekës Publike "Marin Barleti" dhe kontributin e saj në jetën kulturore të Shkodrës Të krijojë forma të reja ndërveprimi midis lexuesve, autorëve, studiuesve dhe artistëve Të promovojë figurën e gruas si qendër e krijimtarisë artistike dhe si burim frymëzimi në art dhe kulturë. Të promovojë poezinë si formën më të ndërthurur dhe të gjallë të artit letrar , duke e sjellë atë më pranë publikut të gjerë në Ditën Ndërkombëtare të Poezisë Të nxisë leximin dhe krijimin letrar tek fëmijët						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit Konferencë me sesione të përcaktuara. Ngritje e një grupi të përbashkët pune. Vizitë njohëse dhe vlerësuese nëpër institucionet kulturore në qytet si dhe në zonat muzeale. Diversifikimin e aktiviteteve kulturore dhe gkithepërshirja e publikut duke synuar rritjen e pjesëmarrjes grupmohave të ndryshme. Promovime librash dhe takime me autorë Ekspozita e grave artiste .Panele diskutimi: Studiues dhe letrarë diskutojnë mbi ndikimin e Migjenit në letërsinë shqipe dhe temat e veprës së tij. Lexime autoriale dhe performanca teatrale: Interpretim i poezive dhe prozës së Migjenit nga aktorë, poetë dhe studentë. Lexime dhe interpretime të veprave për fëmijë						
b) Rezultatet që prisni Formësim i një praktike të përbashkët e cila do t'i vijë në ndihmë institucioneve dhe studiuesve apo personave të interesuar brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me Kujtesën, nëpërmjet dokumentit të shkruar dhe atij vizual. Shtim i aktiviteteve kulturore dhe artistike Rritje e numrit të spektatoreve dhe publikut në këto aktivitete. Rritje e dukshme e vizibilitetit publik të Bibliotekës "Marin Barleti" si institucion kulturor i rëndësishëm në nivel lokal dhe kombëtar. Përfshirje më e gjerë e komunitetit , me rritje të frekuentimit nga lexues, nxënës, studentë dhe familje gjatë dhe pas aktiviteteve. Krijimi i rrjeteve të reja bashkëpunimi midis bibliotekës, autorëve, institucioneve arsimore, organizatave kulturore dhe artistëve. Rritje e interesit për fondet e bibliotekës , veçanërisht për koleksionet e rralla, arkivat dhe dokumentet historike Dokumentim i plotë i historikut të 95 viteve , si bazë për projekte të ardhshme studimore, botuese apo muzeale Rritje e përdorimit të shërbimeve moderne të bibliotekës, përfshi katalogët digjitalë dhe programet e edukimit Informacional Rritje e dukshmërisë së grave artiste dhe interpretese , duke theksuar kontributin e tyre në art dhe kulturë Fuqizim i rolit të gruas në art dhe shoqëri , si krijuese, interpretese dhe frymëzuese. Promovim i artit multidisiplinor , duke bashkuar pikturën, performancën, muzikën, poezinë dhe artin vizual në një program të integruar. Rritje e ndërgjegjësimit të publikut mbi rëndësinë e barazisë gjinore dhe ndikimin e grave në kulturë. Rritje e ndërveprimit të publikut me poezinë , duke e bërë këtë gjini letrare më të arritshme, më të dukshme dhe më pjesëmarrëse. Rritje e interesit për leximin dhe krijimtarinë letrare tek fëmijët, duke nxitur shprehitë e leximit që në moshë të hershme Zhvillim i aftësive krijuese dhe interpretative të fëmijëve përmes punëtorive dhe aktiviteteve praktike						
d) Kontributet e mundshme në projekt Komuniteti i shkrimtarëve, gjuhëtarëve, studiuesve dhe i lexuesve që preferojnë gjuhën, leximin dhe përdorimin e gjuhës geqe.						
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Akomodim dhe Trajtim ushqimor për realizimin I aktiviteteve të trashëgimisë kulturore	197	Paga	Sigurime	Operative	Trans
A.2	Honorare për realizimin I aktiviteteve të trashëgimisë kulturore	395			395	
A.3	Shpenzime për Pritje përcjellje	40			40	

	Shuma	632			632		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferrime	Kapitale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	632			632		
	Shuma	632			632		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferrime	Kapitale
A.1	Shpenzime për aktivitetin	632			632		
	Shuma	632			632		
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Gjatë vitit 2026		Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit					
Gjatë vitit 2027		Stafi i Biblotekës "Marin Barleti", Muzeu Historik					
Gjatë vitit 2028		Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder					

Nr.19	P.AF141.Q2.O1.A5 Shpenzime promionale për aktivitetet e kultures	AF141 Sport dhe Kulture
i. Situata		
Gjate vitit Bashkia Shkoder organizon shume aktivite kulturore, te cilat per tu prezantuar denjesisht kane nevoje per promocionin e duhur. Per kete arsye eshte planifikuar nje fond ne buxhetin e Bashkise Shkoder, per te prezantuar ne nivele profesionale vlerat trashëgimisë kulturore dhe artit ne rajonin tone.		
Muzeu Historik boton çdo vit guidën e vet prezantuese , me një cilësie grafike dhe informuese të denjë per promovimin e tij. Përveç guides Muzeu Historik, gjate vitit, zhvillon aktivite kulturore te ndryshme, te cilat perfshijne materiale promionale per te arritur sa me mire tek publiku. Fondi i parashikuar per te mbuluar promocionin e ketij institucioni është 21 mijë leke ku perfshihen ribotimin e 500 fletpalosje për Muzeun Historik Shkodër dhe 200 fletplosje për Muzeun e Kështjellës. Copë 500 x30 = 15.000 lek . Copë 200x 30= 6.000 lek Për vitin 2026 parashikojmë të kemi ribotimin e Guide Muzeu Historik Shkoder botuar ne 2023 nga bashkia Shkodër. Copë 500 x 200 = 100,000 lek dhe Botimi i një reviste etnografike Muzeu Historik Shkoder. Copë 400 x 150= 60,000 lek.		
Publikime promionale, fletpalosje e guidë për “Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës” Disponohen broshura për aktivitetin e muzeut, për të promovuar këtë aktivitet në evente të ndryshme apo nëpër shkolla, institucione etj. Këto broshura dhe ky informacion jane realizuar vitet e kaluara dhe kane rezultura te suksesshem. Të gjithë vizitorët janë pajisur me këtë material, duke e marrë atë edhe në formën e një souveniri. Është e rëndësishme që muzeu të promovohet dhe njerëzit të dijnë për aktivitetin e tij. Po kështu, materiali me karakter divulgativ mbi historinë e godinës është i rëndësishëm për vetë faktin se ky vend përbën një pasuri për qytetin tonë dhe mbi të gjitha ka një histori unike, e cila ia vlen të evidentohet. Edhe këtë vit është parashikuar printimi i broshurave informative mbi aktivitetin e muzeut dhe publikimi i një materiali me karakter divulgativ mbi historinë e godinës në të cilën gjendet sot Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës. Vlera e ketij shpenzimi eshte 150 mije leke.		
Biblioteka “Marin Barleti” “Letërsia shqipe e pas viteve `90”</b></p> <p>Në kuadrin e Ditës Botërore të Poezisë, në datat 20-22 Mars do të organizohet Festivali “Poezi n`Festë”. Kjo ngjarje kulturore planifikon të përfshijë autorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Përveç performancave poetike të paramenduara si në lexime në grupe ashtu edhe në lexime individuale, do të mbahen edhe panelet e diskutimit me temë “Letërsia shqipe pas viteve `90”. Pjesëmarrësit në panel të cilët janë parashikuar të jenë poetë, shkrimtarë, përkthyes, studiues si dhe botues do të sjellin mendimet, qëndrimet dhe qasjen e tyre ndaj letërsisë shqipe pas viteve `90. Për promocionin e këtij aktiviteti janë parashikuar 10 mijë leke.		
Ne vitin 2026 eshte programi Jubilar i 95-vjetorit te Bibliotekës Publike ‘Marin Barleti’. Programi jubilar është konceptuar si një mozaik veprimtarish që ndërtojnë urën mes traditës dhe të ardhmes. Panelet e diskutimit do të sjellin së bashku studiues, shkrimtarë, përkthyes, bibliotekarë dhe personalitete të kulturës për të trajtuar tema që lidhen me evoluimin e librave, sfidat e lexueshmërisë, rolin e bibliotekave publike në epokën digjitale, si dhe trashëgiminë letrare të Shkodrës. Në kuadër të festimeve do të çelet edhe një sërë ekspozitash tematike. Projekti “95-vjetori i Bibliotekës Publike ‘Marin Barleti’” nuk është thjesht një përkujtim simbolik; ai është një ftesë për të riimagjinuar rolin e bibliotekës si hapësirë e përbashkët kulturore, edukative dhe komunitare. Përmes aktiviteteve të saj, biblioteka synon të forcojë marrëdhëniet me lexuesit, të nxisë dialogun intelektual dhe të krijojë një traditë të re bashkëkohore për brezat që vijnë. Per promocionin eshte parashikuar 10 mije leke buxhet.		
Projekti “Muzat” – Gratë që krijojnë. Me datë 18 Maj në oborrin e brendshëm të Biblioteka Publike "Marin Barleti", hapur pas më shumë se 50 vitesh , u organizua aktiviteti për "Muzat". Një aktivitet dedikuar totalisht figurë së gruas, nëpërmjet poezisë dhe pikturës. “Muzat” është një projekt artistik dhe kulturor që vendos në qendër figurën e gruas si krijuese, inspiruese dhe interpretuese. Ngjarja mbledh së bashku gra artiste, piktores, performuese, poete, muzikante dhe interpretuese të formave të ndryshme të artit, për të sjellë një program multidisiplinor që flet për zërat, historitë, ndjeshmëritë dhe fuqinë krijuese të grave. Përmes ekspozitave, performancave, leximeve artistike, instalacioneve, muzikës live, diskutimeve dhe ndërveprimeve me publikun, “Muzat” krijon një platformë të gjallë për të afirmuar jo vetëm artin që prodhojnë gratë, por edhe përvojën e tyre njerëzore e shoqërore. Për promocionin e këtij aktiviteti janë parashikuar 10 mijë leke.		
Festimi i 115-vjetorit të lindjes së Millosh Gjergj Nikolla – Migjeni, Ky projekt ka për qëllim të nderojë jetën dhe krijimtarinë e një prej figurave më të rëndësishme të letërsisë shqipe, poetit Millosh Gjergj Nikolla, i njohur me pseudonimin Migjeni, në 115-vjetorin e lindjes së tij. Ngjarja synon të rikthejë në vëmendje veprën e tij letrare, ndikimin e tij në letërsinë moderne shqiptare dhe mesazhet e përhershme të poezisë dhe prozës së tij. Ky projekt parashikon një buxhet prej 35 mije lekesh ku perfshin: shpenzime promocioni 10 mije leke		
Galeria e Arteve Shkoder ne kalendarin e saj te aktiviteteve, organizon ekspoziten		
Sallonin e Vjeshtës, i cili hapet ne kuader te aktiviteteve te “Javes se Pavarsise” . Per kete aktiviteti fondi i parashikuar është 10 mijë lekë.		
Personazh i ftuar, aktiviteti tjeter qe organizohet nga Galeria e Artve, ka fond te parashikuar 10 mijë lekë per pormocionin Ekspozite e lire, aktiviteti i cili organizohet nga Galeria e Arteve ka fond te parashikuar per pormocionin 10 mijë lekë. “Laborator punetori IDROMENO” - ka fond te parashikuar per promocion 15 mije leke.		

Qendra Kulturore Pjeter Gaci organizon që nga viti 2000, aktivitetin nderkombetar te muzike se kultivuar Çmimi “Pjetër Gaci” , konkursi i icli promovon talentet e reja ne dege te ndryshme muzikore . Per kete aktivitet fondi i parashikuar është 25 mijë leke. Ahengu shkodran nje aktivitet tradite dhe shume u dashur per publikun, dedikuar këngës popullore shkodrane, realizohet çdo vit me 29 Shtator ne ditën e trashëgimisë kulturore. Per kete aktivitet fondi i parashikuar është 35 mijë leke. Aktivitetet protokollare - Fondi i parashikuar per promocion është 20 mijë leke. Si dhe per cdo aktivitet tjeter qe do realizohet.
ii. Synimi i projektit Pasurimi i informacionit për rrjetin muzeal të Bashkisë Shkodër, ☐ Kthimi në traditë i botimeve permanente promocionale Promovimi i turizmit historik dhe kulturor. Plotësimi i një kërkesë të vazhdueshme të publikut vendas dhe të huaj, për pajisjen me një guidë të tillë.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Përfshirja e më shumë specialistëve në hartimin e promocionit.

Pajisja me module informative të reja dhe bashkëkohore, harta, aplikacione, ëebbsite etj. ☐ Krijimi i grupit të punës dhe hartimi prej tyre i programit të punës,

Ruajtja e standartit dygjuhësh.

b) Rezultatet që prisni

Një pasqyrë më e qartë e pasurisë dhe shpërndarjes së rjetit muzeal dhe atë të trashëgimisë për Bashkinë Shkodër.

Një prezantim më serioz dhe i plotë i asaj çfarë kërkohet nga një guidë përgjithësuese në rrafshin kulturor.

Promovimit të turizmit kulturor dhe hapësirës së Bashkisë Shkodër si gjurmë kulturore në rajon dhe Europë.

c) Aktorët e mundshëm

d) Kontributet e mundshme në projekt

Stafi i Muzeut Historik

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporti

Drejtoria e Turizmit

Publiku vendas dhe i huaj.

Bashkia Shkodër,

Donatorë të mundshëm

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2026

Totali (mijë lekë)

Nga kjo:

Paga

Sigurime

Operative

Transferime

Kapitale

A.1

Shpenzime per promocion

750

750

Shuma

750

750

Shpenzimet për çdo aktivitet 2027

Totali (mijë lekë)

Nga kjo:

Paga

Sigurime

Operative

Transferime

Kapitale

A.1

Shpenzime per promocion

750

750

Shuma

750

750

Shpenzimet për çdo aktivitet 2028

Totali (mijë lekë)

Nga kjo:

Paga

Sigurime

Operative

Transferime

Kapitale

A.1

Shpenzime per promocion

750

750

Shuma

750

750

f) Periudha e zbatimit

Janar –Dhjetor 2026

Janar –Dhjetor 2027

Janar– Dhjetor 2028

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:

Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës,

Biblioteka “Marin Barleti

Drejtoria e Pergjithshme e Kulturës dhe Sportit

Drejtoria e kultures

Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder

Nr. 20	P.AF141.Q2.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës	AF141 Sport dhe Kulture
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
1. Çmimi "Pjetër Gaci" - është një takim interpretuesish në fushën e muzikës së kultivuar. Nga viti 2000 e në vazhdim, ky aktivitet organizohet çdo vit në qytetin e Shkodrës nga Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore "Pjetër Gaci". Dimensionohet si një konkurs ndërkombëtar, i cili nga viti në vit është konsoliduar. Ai është i ndarë në kategori dhe degë të veçanta muzikore dhe pjesëmarrja është e lirë në bazë të kriterëve të përcaktuara nga stafi organizativ, duke bashkëpunuar në mënyrë specifike me shkollat artistike. Regjistrimi në konkurs bëhet kundrejt një shifre financiare, të parashikuar në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër. Juria e çdo kategorie përbëhet nga personalitete të muzikës klasike. Juritë mbledhen në finale për të dhënë Çmimin "Pjetër Gaci". Konkursi promovon talentet e reja në degë të ndryshme muzikore, duke ballafaquar njëkohësisht shkolla dhe stile të ndryshme interpretimi. Ai organizohet në qytetin tonë si një qytet me tradita në këtë fushë dhe mban emrin e "Pjetër Gacit", pasi ai përfaqëson atë brez muzikantësh të mirënjohur, të cilët na dhanë modele të krijimit dhe interpretimit muzikor, duke e transmetuar atë edhe në brezat e ardhshëm. 2. "Ahengu Shkodran" - Pjesë e traditës së këngës popullore shkodrane është dhe "Ahengu Shkodran", i cili me te drejtë është shpallur si një ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë shpirtërore shqiptare. Në ditën e trashëgimisë kulturore, me 29 shtator, organizohet aktiviteti tradicional "Ahengu Shkodran". Synimi kryesor i këtij aktiviteti është përcimi i traditës tek brezat e rinj, përmes njohjes së vlerave kulturore autoktone dhe promovimi i tyre në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Aktiviteti ka një ndjeshmëri të lartë artistike për qytetin. Aty janë të përfshirë forcat më të mira krijuese dhe interpretuese të kësaj trashëgimie. "Ahengu Shkodran" çdo vit ka në përbërjen e tij instrumentistë dhe këngëtarë të rinj në moshë, të cilët i kanë sjellë një frymë të re kësaj rryme muzikore. Aktiviteti do të regjistrohet në studio- audio, masteri i të cilit do të përdoret për promovime të ndryshme. 3. Koncert premiere I orkestres frymore Formacioni i Orkestrës Frymore - është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë. Historia e saj i ka fillimet e saj në vitin 1876. Siç dihet ky formacion është vijues i traditave më të mira të formacioneve që kanë debutuar në qytetin e Shkodrës dhe jo vetëm. E mbështetur nga Bashkia e Shkodrës dhe e menaxhuar nga Qendra Kulturore "Pjetër Gaci", është një formacion mjaft i konsoliduar. Ky formacion është fitues në shumë takime kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara ndër vite të orkestrave frymore, për të cilin është planifikuar shpenzime për Honorare ,promocion. Etj. Pjesëmarrëse në konkurset e realizuara për disa vite me radhë në Sarandë, fituese e Çmimit të parë në GiulianaNova, Itali, e ftuar në vende të ndryshme jashtë Shqipërisë, kjo trupë artistike, është një ndër orkestrat frymore më dinjitoze në rang kombëtar. Çdo vit Orkestra Frymore organizon një koncert premierë që zakonisht përkon me javën e pavarësisë. Në kuadër të kësaj tradite, edhe këtë vit Banda e Shkodrës do të realizojë një koncert premierë me repertor tërësisht të ri, i cili do t'i ofrohet spektatorit në formatin e një spektakli. 4. Koncert Orkestra Simfonike koncert premiere .		

LISTA E HONORAREVE :							
Honorar, Artist i/e ftuar I		45 mije leke					
Honorar, Artist i/e ftuar II		35 mije leke					
Honorar, Artist i/e ftuar III,		25 mije leke					
Honorare juria I		20 mije leke					
Honorare juria II		35 mije leke					
Honorare Konferencier		20 mije leke					
Honorare Skenarist		20 mije leke					
Honorare Instrumentistë		15,000 lekë					
Honorare shoqerues ne piano		15,000 lekë					
Honorar Regjizor		20,000 lekë					
Honorare, Këngëtarë,		10,000 lekë					
Honorare, Këngëtarë të rinj		8,000 lekë					
Honorare, Orkestrues,		5,000 lekë					
Honorar, Konsulent artistik		25 mije lekë					
Honorar, Drejtor artistik		50 mije lekë					
Honorar Cmimi I		50 mije leke					
Honorar Interpretues Cikel i Larte		20 mije leke					
Honorar Cmimi I Cikel i Mesem		14 mije leke					
ii. Synimi i projektit							
Gjallërimi i jetës artistike të qytetit.							
- Edukimi i brezit të ri me bukurinë e këngës shkodrane. - Ruajtja e trashëgimisë shpirtërore jo materiale. - Promovimi i kostumeve popullore të Shkodrës. - Nxitja e turizmit kulturor							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
- Ngritja e grupit realizues. - Bashkëpunim me institucione dhe specialistë që përfaqësojnë shkollat artistike pjesëmarrëse. - Sigurimi i pjesëmarrjes, brenda dhe jashtë vendit. - Përzgjedhja e një jurie profesionale me personalitete shqiptarë dhe të huaj. - Sigurimi i infrastrukturës, hoteleri, restorante dhe ambiente ku do të mbahen audicionet. - Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promocionale. - Realizimi i dekorit. - Bashkërendimi i punëve me zyrën ekonomike të Teatrit “Migjeni” për realizimin e aktivitetit.							
b) Rezultatet që prisni							
- Rritje e interesit dhe e cilësisë së interpretimit të muzikës së kultivuar. - Edukimi i shijeve artistike të artdashësve në masë të gjerë. - Promovimi i talenteve të reja në fushën e muzikës së kultivuar. - Vlerësimi i figurës së Pjetër Gacit.							
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt					
Artistët e rinj dhe artdashësit.		Bashkia Shkodër.					
Shkollat artistike		Të ardhurat nga regjistrimet.					
Komuniteti artistik.		Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër Teatri “Migjeni”.					
		Shoqata artistike					
		Donatorë të mundshëm.					
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1	Shpenzime per realizimin e aktiviteve	2,924	Paga	Sigurime	Operative	Tansferime	Kapitale
					2,924		
		2,924			2,924		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1	Shpenzime per realizimin e aktiviteve	2,924	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
		2,924			2,924		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1	Shpenzime per realizimin e aktiviteve	2,924	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
		2,924			2,924		
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
2026,2027,2028		Stafi i Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci”, Drejoria e Kultures					
		Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder					

Nr.31	P.AF141.Q2.O3.A11 Honorare "Grupi i valleve"	AF141 Sport dhe Kulture					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i.Situata							
Grupi i valleve ka një traditë në vite me një numër të madh pjesëmarrësish dhe drejtuesish të njohur, të cilët kanë kontribuar në shumë aktivitete të ndryshme, duke na lënë një pasuri të çmuar në këtë fushë. Siç dihet edhe kërcimi dhe vallja kanë shoqëruar popullin tonë në festa të ndryshme me karakter familjar apo ritualistikderi në kohët e sotme. Profesionistë dhe amatorë të kësaj fushe u mbështetën në këtë traditë të pasur dhe arritën të realizonin shfaqje me vlera artistike në bashkëpunim edhe me arte të tjera të zhvilluara në qytetin tonë. Ndër vite janë inskenuar tablo të ndryshme, akte operash, dasma, përfaqësim ansamblesh brendadhe jashtë vendit. Pjesëmarrja e grupit të valleve ka qenë thujse në të gjitha festivalet popullore dhe folklorike ku edhe është nderuar me trofe si grup dhe në elementët veçantë solistik të tij. Vitet e shkuara ky grup mori pjesë në disa shfaqje të karaktereve të ndryshme, të realizuara në territorin e Bashkisë Shkodër si dhe përfaqësoi Shqipërinë në Festivalin e Ansambleve Popullore në Priepolie, Serbi. Bashkia Shkodër e ka financuar rregullisht për 10 muaj të vitit,por edhe duke i siguruar realizimin e aktiviteteve të shumta. Kjo trupë duhet të vazhdojë të financohet edhe në vazhdim me të njëjtat honorare dhe kushte që ka aktualisht. Grupi i valleve i mbështetur nga Bashkia Shkodër do të menaxhohet nga Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" që ka në dispozicion koreografin dhe bazën materiale që i duhet trupës. Kjo trupë përbëhet nga 12 persona, 6 vajza dhe 6 djem për 10 muaj të vitit. Ajo do t'i përgjigjet të gjitha aktiviteteve artistike ku kërkohet një trupë e këtij formati. Programi është pjesëmarrja në festa të ndryshme të qytetit tonë, si Festa e Luleve, koncerte të shkurta në sezonin veror, në festën e Ahengut Shkodran, në festimet e javës së Pavarësisë, etj si dhe pjesëmarrja në të gjitha festat folklorike në Shqipëri sipas kalendarit të Ministrisë së Kulturës.							
ii. Synimi i projektit							
• Ruajtja e traditës së këtij formacioni. • Realizimi i aktiviteteve me rastin e festave të ndryshme. • Promovimi i vlerave artistike të kësaj trupe. • Nxitja e turizmit kulturor.							
iii.Aktivitetet kryesore të projektit							
• Realizimi i marreveshjes se bashkepunimit me valltarët. • Realizimi i projekteve të ndryshme artistike për trupën dhe konkretizimi i tyre. • Përzgjedhja e repertorit për të gjitha aktivitetet. • Prova intensive me trupën. • Përgatitja e materialeve promociionale. • Promovimi në media i të gjitha aktiviteteve.							
b) Rezultatet që prisni							
• Ruhjet tradita e këtij formacioni. • Edukimi i brezit të ri me elementët e traditës dhe asaj bashkëkohore. • Spektatorët marrin kënaqësinë e dëshiruar gjatë performancave artistike.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Komuniteti artistik, valltarët, spektatorët e kualifikuar dhe masa e gjerë.				Bashkia Shkodër.			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026				Totali (mijë lekë)			
A.1 Honorare Grupit të Valleve 12 persona x 10muaj x 8 lekë				960			
Shuma				960			
Shpenzimet për çdo aktivitet				Totali (mijë lekë)			

2027		lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorare Grupit të Valleve 12 persona x 10muaj x 8 lekë	960			960		
	Shuma	960			960		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1	Honorare Grupit të Valleve 12 persona x 10 muaj x 8 lekë	960	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma	960			960		
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2026 Janar – Dhjetor 2027 Janar – Dhjetor 2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci”, Drejtoria e Kultures Institucioni Likuidues: Bashkia Shkoder					

Nr. 32	P.AF141.Q2.O3.A12 Festivali i Këngës “Luleborë”	AF141 Sport dhe Kulture																																												
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:																																														
i. Situata																																														
Festivali është një ndër të paktat aktivitete në nivel kombëtar që përfaqëson këngën e sotme shqiptare me intonacionet karakteristike të saja, në përpjekje për ta projektuar atë, larg anakronizmave dhe barbarizmave diletanteske, duke ndjekur disa nga standardet estetike të tregut botëror në përshtatje me tregun tonë muzikor. Festivali i Këngës “Luleborë” u zhvillua në datat 27 dhe 28 Tetor 2025 dhe prezantoi 16 krijime të reja. Është me rëndësi të përmendet fakti që çdo vit e më shumë marrin pjesë kompozitorë të rëndësishëm të artit shqiptar, duke i dhënë nivel të lartë krijimeve të këtij festivali. Bashkia Shkodër vitin 2026 organizon edicionin e njëmbëdhjetë të Festivalit të Këngës “Luleborë” dhe ka planifikuar organizim dhe format të ri në lidhje me zhvillimin e tij duke sjellë për publikun një spektakël të vërtetë. Festivali “Luleborë” ka si qëllim të sjellë tek publiku këngën, duke i dhënë asaj një dimension të ri; përmes nxitjes së profesionalizmit dhe nivelit të lartë artistik si dhe interpretimit “live” të çdo elementi të këtij festivali.																																														
LISTA E HONORAREVE																																														
<table><tr><td>Honorare, Autori i muzikës,</td><td>50,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorare, Autori i tekstit</td><td>35,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorare, Orkestrues</td><td>30,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorare, Këngëtar,</td><td>35,000 lekë</td></tr><tr><td>Instrumentist Band</td><td>45,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorare,instrumentist,Harqe,Fryme.(25persona)</td><td>35.000 leke</td></tr><tr><td>Honorare, Çmimi i parë,</td><td>150,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorare, Çmimi i dytë</td><td>70,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorare, Çmimi i tretë</td><td>50,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorar, Udhëheqës artistik</td><td>150,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorar, Regjisor</td><td>150,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorar, Skenari</td><td>70,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorare, Juria</td><td>50,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorare, Moderator</td><td>150,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorar, Produksion Muzikor</td><td>100,000 leke</td></tr><tr><td>Honorare, Skenograf</td><td>100,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorare, Dirigjent</td><td>150,000 lekëlekë</td></tr><tr><td>Honorar per realizim video</td><td>5.000leke/video</td></tr><tr><td>Honorare, të Ftuar</td><td>50,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorar, post produksion audio</td><td>100,000 lekë</td></tr><tr><td>Honorar,Koncertmaester</td><td>70,000 leke</td></tr><tr><td>Honorar Asistent dirigjent</td><td>60,000 leke</td></tr></table>			Honorare, Autori i muzikës,	50,000 lekë	Honorare, Autori i tekstit	35,000 lekë	Honorare, Orkestrues	30,000 lekë	Honorare, Këngëtar,	35,000 lekë	Instrumentist Band	45,000 lekë	Honorare,instrumentist,Harqe,Fryme.(25persona)	35.000 leke	Honorare, Çmimi i parë,	150,000 lekë	Honorare, Çmimi i dytë	70,000 lekë	Honorare, Çmimi i tretë	50,000 lekë	Honorar, Udhëheqës artistik	150,000 lekë	Honorar, Regjisor	150,000 lekë	Honorar, Skenari	70,000 lekë	Honorare, Juria	50,000 lekë	Honorare, Moderator	150,000 lekë	Honorar, Produksion Muzikor	100,000 leke	Honorare, Skenograf	100,000 lekë	Honorare, Dirigjent	150,000 lekëlekë	Honorar per realizim video	5.000leke/video	Honorare, të Ftuar	50,000 lekë	Honorar, post produksion audio	100,000 lekë	Honorar,Koncertmaester	70,000 leke	Honorar Asistent dirigjent	60,000 leke
Honorare, Autori i muzikës,	50,000 lekë																																													
Honorare, Autori i tekstit	35,000 lekë																																													
Honorare, Orkestrues	30,000 lekë																																													
Honorare, Këngëtar,	35,000 lekë																																													
Instrumentist Band	45,000 lekë																																													
Honorare,instrumentist,Harqe,Fryme.(25persona)	35.000 leke																																													
Honorare, Çmimi i parë,	150,000 lekë																																													
Honorare, Çmimi i dytë	70,000 lekë																																													
Honorare, Çmimi i tretë	50,000 lekë																																													
Honorar, Udhëheqës artistik	150,000 lekë																																													
Honorar, Regjisor	150,000 lekë																																													
Honorar, Skenari	70,000 lekë																																													
Honorare, Juria	50,000 lekë																																													
Honorare, Moderator	150,000 lekë																																													
Honorar, Produksion Muzikor	100,000 leke																																													
Honorare, Skenograf	100,000 lekë																																													
Honorare, Dirigjent	150,000 lekëlekë																																													
Honorar per realizim video	5.000leke/video																																													
Honorare, të Ftuar	50,000 lekë																																													
Honorar, post produksion audio	100,000 lekë																																													
Honorar,Koncertmaester	70,000 leke																																													
Honorar Asistent dirigjent	60,000 leke																																													
• Pasurimi i repertorit të këngës; • Afrimi dhe aktivizimi i brezave të rinj në muzikë, përmes krijimtarisë muzikore, krijimtarisë letrare si dhe interpretimit vokal / instrumental; • Zhvillimi profesional i këngës duke kombinuar ngjyrat dhe tingëllimet e traditës, të futura në formatin bashkohorë të rrymave Pop të tregut muzikor.																																														
iii. Aktivitetet kryesore të projektit																																														
• Ngritja e grupit realizues. • Kontakti me krijuesit, përzgjedhja e këngëve, këngëtarëve dhe instrumentistëve. • Prova intensive me orkestrën dhe këngëtarët. • Sigurimi i ambjenteve, fonisë, ndriçimit dhe e gjithë bazës materiale. • Përgatitja e materialeve promocionale dhe reklamimi cilësor në media. • Realizimi i dekorit të ambjenteve. • Bashkërendimi i punëve me stafin realizues.																																														
b) Rezultatet që prisni																																														
• Rritja e interesit për të gjithë komunitetin artistik dhe artdashës, për ruajtjen dhe pasurimin • me repertor të ri të kësaj trashëgimie, e cila na dallon nga kulturat e komuniteteve të tjera. • Rritja e nivelit artistik të krijimit dhe të interpretimit. • Gjallërimi i mëtejshëm i jetës artistike në qytet dhe më gjerë.																																														

c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt					
☐ Komuniteti artistik dhe artdashës		Bashkia Shkodër. Teatri "Migjeni". Të ardhurat nga biletat. Donatorë të mundshëm.					
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Honorare	6,265			6,265		
A.2	Akomodim ne hotel per te ftuar	200			200		
A. 3	Trajtim ushqimore per te ftuar	200			200		
A.4	Koktejl per darken finale permbyllese	200			200		
A.5	Materiale per realizim skenografie	200			200		
	Shuma	7,065			7,065		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Shpenzimet për aktivitetin	7,030			7,030		
	Shuma	7,030			7,030		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028			Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Shpenzimet për aktivitetin	7,030			7,030		
	Shuma	7,030			7,030		
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Janar– Dhjetor 2026 Janar – Dhjetor 2027 Janar – Dhjetor 2028		Drejtoria e Kultures, Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" Teatri Migjeni Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.33	P.AF141.Q2.O3.A13 Realizimi i Aktiviteteve te organizuara nga Drejtoria e Kultures.	AF141 Sport dhe Kulture
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
Drejtoria e Kulturës përgjatë vitit 2026 do të organizojë aktivitete kulturore artistike te zhanreve te ndryshme. Fokusi i saj është të shndërrojë Shkodrën në një skenë të madhe, me artiste kombetar dhe nderkometar, promovues të trashëgimisë tone kulturore por edhe nderthurje dhe shkëmbim eksperiencash me qytete evropiane.		
Dita e Luleve është Festa Shën Gjergjit. Në vitin 2006, në Shkodër u rikthe tradita e festimit të ditës së luleve dhe që prej asaj kohe, Bashkia Shkodër e mbështet këtë aktivitet çdo vit. Çdo 6 Maj, Në vitin 2025 e titulluar “Festa e luleve”, e cila zgjat një javë ndryshe nga vitet e tjera, për tu përmbyllur me datë 6 Maj u organizuan këto aktivitete: - “Panairi i luleve”, me kultivuesit e luleve, biznese dhe qytetarë të thjeshtë. - Konkurse me fëmijët e sistemit parashkollor, 9- vjeçar dhe të mesëm. - “Festivali i luleve”; dedikuar vetëm fëmijëve - 3 Koncerte festive me pjesëmarrjen e Orkestrës së Teatrit Migjeni , nata greke dhe swing marathone Edhe për vitin 2026 do të ruhet tradita e aktivitetit dhe formati i saj duke shtuar disa aktivitete si: - Koncert me të ftuar kombetar. Gjatë vitit 2026 do të bëhet detajimi i buxhetit sipas kalendarit dhe do të përcaktohet menyra e realizimit të aktivitetit ose/dhe përzgjedhja e projektit m e të mirë nga keshilli artistik.		
Festival Jazz-i - “Festival Jazz-it” - projekt i titulluar nga subjekti fitues “Shkodra Universal Sounds -Shkodra Jazz Festival” i cili përfshinte : “Shkodra Sounds” dhe “Rrok Academy” , u zhvillua në datat 11 gusht – 31 gusht 2025. Në datën 11 gusht 2025 në ambientet e Qendrës Rinore “Atelie” , Shkodër, në orën 09:00 u bë hapja “Rrok Academy” Junior e drejtuar nga Brixhilda Martini. Në “Rrok Academy” Junior morën pjesë 15 studente nga qyteti i Shkodrës, Lezhës, Tiranës, Durrësit dhe Italia. Me datën 11 gusht u hap dhe dega e Fizarmonikës e cila u drejtua nga Bardh Jakova. Në degën e Fizarmonikës morën pjesë 5 student dhe dy profesore të cilët ishin nga Shqipëria, Romania, Mali i Zi dhe Kosova. “Rrok Academy Klasike ” filloi me datën 14 -25 Gusht 2025 në ambientet Galerisë së Arteve Shkodër ,nën drejtimin e Paçalin Pavacit. Në “Rrok Academy Klasike ” morën pjesë 10 studente nga Shqipëria, Kosova dhe Italia. “Rrok Academy Jazz” filloi me datën 18 Gusht 2025, në ambientet e Qendrës Rinore “Atelie” nën drejtimin e Markelian Kapidanit . Në “Rrok Academy Jazz” morën pjesë 16 studentë nga Shqipëria, Kosova dhe Italia. në “Shkodra Jazz Festival”, u mbajtën orë speciale në “Rrok Academy Jazz” ku leksionet e trombës nga Gabriel Oscar Rosati; leksionet e bass-it nga Flavio Piantoni. Dega New Technology – Multimedia filloi me datën 11-31 Gusht 2024 , në ambientet e Qendrës Rinore “Atelie” nën drejtimin Fatjon Çelikut. Në degën New Technology – Multimedia morën pjesë 6 studentë. “Shkodra Universal Sounds- Shkodra Jazz Festival” pasuroi jetën kulturore të Shkodrës duke ofruar një mundësi të jashtëzakonshme për të shijuar muzikë të cilësisë së lartë në ambientet me karakteristike të qytetit. Nga tingujt e rafinuar të muzikës klasike, tek emocionet e fuqishme të xhazit, Shkodra në gushtin e vitit 2025 ishte një pikëtakim i artistëve të talentuar dhe dashamirësve të muzikës nga mbarë bota. “Rrok Academy” është element i rëndësishëm i “Shkodra Universal Sounds- Shkodra Jazz Festival” i cili ka si synim rritjen e profesionalizmit tek nxënësit të cilët studiojnë muzikë, përmes shkëmbimit të eksperiencave me artistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe njohjes së rrymave dhe stileve të ndryshme muzikore. Gjatë vitit 2026 do të bëhet detajimi i buxhetit sipas kalendarit dhe do të përcaktohet menyra e realizimit të aktivitetit ose/dhe përzgjedhja e projektit m e të mirë nga keshilli artistik.		
Koncertet e Verës janë menyra më e mirë për atraksionin e turistëve, argëtimin dhe gjallërimin e jetës në territorin e Bashkisë Shkodër gjatë sezonit veror. Gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht 2025, Bashkia Shkodër organizoi mbi 20 koncerte dhe një seri aktivitete kulturore të hapura për publikun, të cilat u pritën me entuziazëm të madh nga qytetarët dhe vizitorët e shumtë. Këto ngjarje u zhvilluan në hapësira publike ikonike të qytetit si pedonalja Gjuhadol dhe sheshi para Bashkisë, duke krijuar një atmosferë të gjallë kulturore dhe festive në qendër të Shkodrës. Gjatë vitit 2026 do të bëhet detajimi i buxhetit sipas kalendarit dhe do të përcaktohet menyra e realizimit të aktivitetit ose/dhe përzgjedhja e projektit me të mirë nga keshilli artistik.		
Shkodra n’fest është projekt i cili do të dedikohet aktivitete që do të organizohen në pika të ndryshme të qytetit në kuadër të festave të fundvitit. Ky projekt ka për qëllim organizimin e koncerteve të cilat përfshijnë artistët shkodranë, grupet rinore, profesionistë, të ftuar special dhe një hapsirë e veçantë do të dedikohet tërësisht aktiviteteve për fëmijë. Për vitin 2024 është dhënë një rëndësi e veçantë pasurimit të jetës kulturore duke përfshirë të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, për ti dhuruar qytetit tonë magjinë dhe atmosferën e jashtëzakonshme të festave, siç ndodhë në çdo vend të zhvilluar të Europës. Përgjatë gjithë muajit Dhjetor 2024 cdo ditë para sheshit të bashkisë Shkodër u realizuan performanca nga të gjitha kopshtet e shkollat e Territorit të Bashkisë Shkodër, duke sjelle gjallëri dhe entuziazem si tek fëmijët por edhe tek te rrituri. Darkat në sheshin para Bashkisë Shkodër ishin plot koncerte, ku u realizuan 20 të tilla me artistë si Rezarta Smaja, Saviana Vjerdha, Frederik Ndoci, Orjeta Kelaj, Bujar Qamili , Laorjan Ejlli, Mukades Canga, Martina Serreqi, Bruna Sata, Ademir Fresku etj. Ne prap Krishtlindje dhe naten e nderimit të viteve u realizuan koncerte me artistet të mirënjohur kombetar. Gjatë vitit 2026 do të bëhet detajimi i buxhetit sipas kalendarit dhe do të përcaktohet menyra e realizimit të aktivitetit ose/dhe përzgjedhja e projektit me të mirë nga keshilli artistik.		

Festa e Trashëgimisë Kulturore. - Aktivitetet ne kuader te “Festes se Trashëgimisë Kulturore”, u zhvilluan në datat 24-25-26 Korrik. Për tre nete rresht “Za Fest” solli artistët më në zë të momentit duke bashkuar arti modern me traditën, në një skenë plot emocione, që njëkohësisht promovon pasuritë e trashëgimisë kulturore të qytetit. Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore ka qenë gjithmonë një prioritet për Bashkinë e Shkodrës. Aktiviteti “Festa e Trashëgimisë Kulturore” përmes projektit ZaFest ndikon pozitivisht jo vetëm në gjallërimin e jetës artistike në qytet, kultivimin e muzikës së mirë, por edhe në promovimin e territorit të Bashkisë Shkodër ne Shqipëri dhe jashtë saj, përmes promovimit të vlerave artritike, kulturore dhe historike të qytetit. Aktiviteti u ndoq nga një publik i gjerë në të tre netët që u zhvillua, kjo edhe për shkak të përzgjedhjes së artistëve pjesëmarrës dhe të mesazheve që u përcollën por edhe për shkak të vendeve me rëndësi të vecantë historike e kulturore, ku u zhvilluan. Gjate vitit 2026 do te behet detajimi i buxhetit sipas kalendarit dhe do te percaktohet menyra e realizimit te aktivitetit ose/dhe perzgjedhja e projektit me te mire nga keshilli artistik.
“Koncert Ndërkombëtar” Më datë 5 shtator 2025, në Sheshin Qendror të Shirokës, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Fondacionin “Arte” dhe institucionet e tjera kulturore, i dhuroi qytetarëve një mbrëmje të jashtëzakonshme muzikore me pjesëmarrjen e tenorit me famë botërore Saimir Pirgu dhe Orkestrës Simfonike të Shkodrës, nën dirigjimin e Elda Laro. Saimir Pirgu është një nga tenorët më të suksesshëm shqiptarë në skenat botërore, i njohur për bashkëpunimet me dirigjentë dhe teatro të nivelit më të lartë si La Scala, Metropolitan Opera apo Wiener Staatsoper. Zëri i tij i ngrohtë dhe interpretimi i fuqishëm mbartin një ndjeshmëri të veçantë, e cila u ndje fuqishëm edhe në këtë mbrëmje në Shirokë. Ai solli një performancë që ndërthur mjeshtërinë vokale me emocionin e singertë, duke e bërë publikun pjesë të çdo note dhe fjale të kënduar. Mbrëmja u moderua nga Ema Ndoja. Skena ishte konceptuar në mënyrë profesionale dhe e pozicionuar në qendër të sheshit, duke ofruar një pamje mbresëlënëse drejt liqenit të Shkodrës. Një moment i veçantë dhe emocionues i koncertit ishte interpretimi i “Ave Maria”, i dedikuar Nënë Terezës, në ditën e shenjtërimit të saj. Ky moment u shoqërua nga Kori i Fëmijëve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija”, duke krijuar një atmosferë solemne e prekëse që pushtoi të gjithë të pranishmit. Edhe per vitin 2026 ky projekt ka për qëllim të ftojë artistë me famë ndërkombëtare më në zë të momentit, duke i dhuruar qytetit koncert madheshtorë dhe duke e renditur atë në qytetet e zhvilluara te Europes, ku koncerte te tilla nuk mungojne asnjehere. Gjate vitit 2026 do te behet detajimi i buxhetit sipas kalendarit dhe do te percaktohet menyra e realizimit te aktivitetit ose/dhe perzgjedhja e projektit m e te mire nga keshilli artistik.
Koncert recital, Ne 2025 u realizua koncerti recital i kengetarit te mirenjohur ne te gjithe Shqiperine Bujar Qamili. Koncerti u zhvillua ne sheshin perpara Bashkise Shkoder. Ne 2026 do te jete një koncert tjetër që i jep mundësinë një artisti Shkodran apo Kombëtar që të bëjë një koncert premirë recital në Shkodër. Recitalet janë një formë promovimi dhe lancimi i një albumi të ri apo dhe risjellje e hiteve më të mira nga artisti. Gjate vitit 2026 do te behet detajimi i buxhetit sipas kalendarit dhe do te percaktohet menyra e realizimit te aktivitetit ose/dhe perzgjedhja e projektit m e te mire nga keshilli artistik.
Festivale te Artit Audiovizual Bashkia Shkder vitet e fundit në mbeshjtetje dhe bashkepunim me trete , ka organizuar aktivite të ndryshme ne lidhje me artin audiovizual. Ky projekt kërkon të eksplorojë lidhjet mes artit bashkëkohor e kinemasë dhe ta vendosë atë përballë publikut shkodran e më gjerë duke ka sjellë në Shkodër, filma të realizuar nga artistë e regjizorë shqiptare dhe të huaj, dokumentarë mbi artin bashkëkohor, filma me merazhe te gjata dhe te shkurter, eksperimental e video art, takime me artistë e kuratorë, profesionistë dhe dashamirës të kinematografisë dhe artit etj. Ky aktivitetet do te detajohet gjate vitit dhe do kete shtrirje kohore pergjate gjithe vitit . Gjate vitit 2026 do te behet detajimi i buxhetit sipas kalendarit dhe do te percaktohet menyra e realizimit te aktivitetit ose/dhe perzgjedhja e projektit m e te mire nga keshilli artistik.
ii. Synimi i projektit
• Nxitja e kultivuesve të luleve, si një traditë e hershme e qytetit tonë, • Promovimi i qytetit përmes shfaqjes së trashëgimisë tonëshpirtërore, • Shkodra të ketë një Festival Jazz, si çdo qytet tjetër i emancipuar në Europë; • Bashkëpunimi me artistë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë; • Përfshirja e të rinjve (grupe/solistë), • Gjallërimi i jetës artistike gjatë verës, • Promovimi i pikave turistike të qytetit tonë dhe Njësie Administrative • Promovimi i vlerave të trashëgimisë tonë kulturore • Zhvillimi dhe gjallërimi i qytetit në muajin e festive të fundvitit; • Krijimi i një qendre atraktive për turizmin • Vendosja e kontakteve dhe krijimi i grupeve të punës për: përzgjedhjen e filmave dhe videove,
iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Shpallja e ftesës së hapur për pjesëmarrje në konkurim për realizimin e projektit, Vlerësim i propozimeve nga ana e Këshillit Artistiko- Kulturor, të Bashkisë Shkodër, Marrëveshje për organizimin e të gjithë aktivitetit ndërmjet stafit të Bashkisë Shkodër dhe subjektit fitues, Nxitja për zhvillim të aktivitetit në parametrat e kërkuar në Ftesën e Hapur, Organizimi i aktivitetit, Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit.						
b) Rezultatet që prisni						
• Trashëgimi në traditën e rritjes dhe kultivimit të luleve, • Pasurimi i territorit të Bashkisë Shkodër me aktivitete artistiko- kulturore, • Pjesëmarrje e gjerë e qytetarëve, • Aktivizimi kulturor i gjeneratave të reja. • Promovim i territorit • Zhvillim ekonomik						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)			
Subjekte të ndryshme që zhvillojnë aktivitete artistiko-kulturore, Muzikantë të shquar ndërkombëtarë, Muzikantë të shquar kombëtarë, Grupet rinore			Bashkia e Shkodrës Donatorë të mundshëm			
e) Shpenzime tëllogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillimi i Aktiviteteve	18,000			18,000	
	Shuma	18,000			18,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillimi i Aktiviteteve	18,000			18,000	
	Shuma	18,000			18,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillimi i Aktiviteteve	18,000			18,000	
	Shuma	18,000			18,000	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar – Dhjetor 2026 Janar – Dhjetor 2027 Janar – Dhjetor 2028		Drejtoria e Kulturës Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.34	P.AF141.Q2.O3.A14 "Ndërmendje"	AF141 Sport dhe Kulture					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
i. Situata							
Koncerti i fundvitit, i kthyer tashmë në traditë, është një Koncert "Galá" i fundvitit që mbahet në Teatrin Migjeni. "Ndërmendje" është një koncert muzikor, në të cilin ekzekutohen kryesisht pjesë nga autorë të njohur nga vendi dhe bota. Koncerti pasurohet edhe me pjesëmarrjen e artistëve më të shquar vendas dhe të huaj, të ftuar si solistë, apo orkestrantë. Ndërmendje, është kurorëzimi i të gjithë aktiviteteve që Bashkia realizon brënda vitit. Pikërisht për këtë veçanti të këtij aktiviteti, vihet re një interes i madh nga publiku i qytetit i cili e pret me gëzim këtë eveniment koncertor. Gjithashtu, vlera e aktivitetit merr përmasa më domethënëse dhe për vetë praninë e Orkestrës Sinfonike e cila përmes performancës së saj, i shton mbrëmjes dimensionet e një koncerti madhor të mbylljes së vitit.							
ii. Synimi i projektit							
- Ruajtja dhe promovimi i vlerave të muzikës së kultivuar nëpërmjet interpretimit profesional; - Aktivizimi informacioneve klasike; - Pasurimi i repertorit klasik, për artistët dhe artdashësit; - Zhvillimi dhe gjallërimi i jetës artistike, kulturore në qytet, gjatë festave të fundvitit.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
☐ Shpallja e ftesës së hapur për pjesëmarrje në konkurim për realizimin e projektit, Vlerësim ☐ i propozimeve nga ana e Këshillit Artistiko- Kulturor, të Bashkisë Shkodër, ☐ Marrëveshje për organizimin e të gjithë aktivitetit ndërmjet stafit të Bashkisë Shkodër dhe subjektit fitues, ☐ Nxitja për zhvillim të aktivitetit në parametrat e kërkuar në Ftesën e Hapur, ☐ Organizimi i aktivitetit, ☐ Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit.							
b) Rezultatet që prisni							
- Aktivizimi i orkestrës simfonike, - Rritja e nivelit muzikor dhe bashkëpunimi ndërmjet artistëve, - Kultivimi i muzikës klasike, - Promovimi i turizmit kulturor.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" Stafi i Teatrit "Migjeni" Artistë dhe grupe të ndryshme artistike				Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm.			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Ndërmendje"	1,500				1,500	
	Shuma	1,500				1,500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Ndërmendje"	1,500				1,500	
	Shuma	1,500				1,500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit "Ndërmendje"	1,500				1,500	
	Shuma	1,500				1,500	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Dhjetor 2026 Dhjetor 2027 Dhjetor 2028		Drejtoria e Kulturës Qendra Kulturore Pjetër Gaci Teatri Migjeni Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.35	P.AF141.Q2.O3.A15 Karnevalet	AF141 Sport dhe Kulture					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
Karnevalet janë një formë festive e njohur në gjithë botën. Veçanarisht në qytetin e Shkodrës, karnevalet janë festuar që në vitin 1861. Kostumet nga më të larmishmit, këngëtarë, qytetarë të tjerë, të gjithë me maska, kanë sfiluar nëpër rrugët e qytetit: nga pjaca përgjatë rrugës muzeale “Kolë Idromeno”. Karnavale 2025 i titulluar “Karnevalet e Shkodrës”, u zhvillua në datat 17-23 Shkurt 2025. Në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore, Drejtorinë e Kulturës dhe strukturave të kulturës së Bashkisë Shkodër, 24 shkolla 9-vjeçare dhe 5 gjimnaze iu përgjigjën ftesës për pjesëmarrje në projektin “Karnevale ” duke performuar nga data 17.02.2025 deri me datë 21.02.2025 tek sheshi “Nënë Tereza” ku ishte vendosur edhe njera nga skenat. Gjatë gjithë javës në hollin e bashkisë Shkodër nga ora 17:00 kishte aktivitete të ndryshme për fëmijë, si facepainting,puntori në ndërtimin e maskave dhe loja argetuese nga klounë profesionistë. As këtë vit nuk mungoi Mapping Show, i cili çdo darkë kishte spektakël para sheshit të Bashkisë Shkodër dhe Prefekturës.Bashkia Shkodër e mbështet këtë projekt çdo vit, si një vlerë e padiskutueshme e qytetit tonë. Ruajtja e traditës në organizimin e Karnavaleve, si një ndër qytetet e vetme në Shqipëri që ruan ende tipologjinë e tyre kombëtare, është e rëndësishme jo vetëm për qytetin, por edhe më gjerë.Gjate vitit 2026 do te behet detajimi i buxhetit sipas kalendarit dhe do te percaktohet menyra e realizimit te aktivitetit ose/dhe perzgjedhja e projektit m e te mire nga keshilli artistik.							
ii. Synimi i projektit							
- Ruajtja e traditës në festimin e karnavaleve tipike shkodrane. - Transmetimi në komunitet i mesazheve të ndryshme paqeje, pajtimi, tolerancë, mirëkuptimi dhe asaj që është më e rëndësishme, të drejtësisë. - Të ndikojnë në përmirësimin dhe gjallërimin e jetës kulturore të qytetit e më gjerë. - Të bëhen Karnevalet një atraksion për shqiptarët dhe turistët e huaj, që do të duan të vizitojnë Shkodrën në këtë periudhë. - Synohet futja e Karnavaleve në guidat turistike në mënyrë që të jenë sa më të promovuara. - Kërkohej që festa e karnavaleve të bëhet përherë e më tepër, festë mbarëqytetare, jo vetëm të prezencës shikuese por dhe të aktivizimit direkt të tyre me paraqitjen karnavaleske, qoftë kjo edhe modeste si dhe festimit të saj në familje, rrugë, lagje apo lokale, etj.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
- Bashkërendimi i punëve me institucionet e varësisë; - Komunikimi me shkollat 9 vjeçare dhe të mesme - Përzgjedhja e aktorëve pjesëmarrës - Organizimi i aktivitetit, - Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit.							
b) Rezultatet që prisni							
- Përfshirje e shumë aktorëve shoqërorë në këtë aktivitet, - Promovimi i turizmit kulturor, - Përmirësimi dhe gjallërimi i jetës social- kulturore në qytetin e Shkodrës. - Gjithëpërfshirja e komunitetit dhe pjesëmarrje e gjerë e komunitetit në festime.							
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt						
Institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër Shkollat e qytetit Artistët (aktorë, poetë, instrumentistë, etj)	Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm Institucionet publike (Policia, ZVA, etj)						
e)Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit te Kanevaleve	8,000				8,000	
	Shuma	8,000				8,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit te Kanevaleve	3,000				3,000	
	Shuma	3,000				3,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Zhvillimi i aktivitetit te Kanevaleve	3,000				3,000	
	Shuma	3,000				3,000	
	Shuma	3,000				3,000	
f) Periudha e zbatimit Shkurt – Mars 2026 Shkurt – Mars 2027 Shkurt - Mars 2028		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kulturës, Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.36	P.AF141.Q2.O3.A16 Festivali Mbarekombetar i humorit ne Shkoder	AF141 Sport dhe Kulture														
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit																
i. Situata (Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)																
Teatri "Migjeni" mbart një trashëgimi të pasur në nxitjen dhe zhvillimin e jetës kulturore të qytetit të Shkodrës, e njohur si "Qyteti i Humorit" për humorin e saj të veçantë dhe për historinë e gjatë të komedisë dhe satirës. Me synimin për të rigjallëruar këtë traditë dhe për t'i kthyer Shkodrës një pjesë të rëndësishme të identitetit të saj artistik, Teatri "Migjeni" filloi në vitin 2024 Festivalin Mbarëkombëtar të Humorit. Ky festival përbën një urë lidhëse midis artistëve dhe publikut të trevave shqipfolëse, duke përfshirë Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe komunitete të tjera shqiptare. Gjate vitit 2024 u zhvillua edicioni i pare i ketij festivali i cili u mbajt ne 5 dite me pjesemarres ne disa disiplina. Në vitiN 2025 shënohet edicionin e dytë të festivalit. Këtë vit, festivali do të rikoncepohet duke e kthyer në një festival të mirëfilltë ndërkombëtar të komedisë. Festivali Ndërkombëtar i Komedisë do të kthejë Shkodrën në qendrën e komedisë për 9 ditë me radhë. Do të forcojë marrëdhëniet mes teatrove, qyteteve, aktorëve, regjisorëve e më gjerë. Viti 2026 shënon edicionin e trete të festivalit, duke sjellë një koncept të freskët që përqendrohet te një atmosferë miqësore dhe festive.. Struktura e Festivalit për vitin 2026 - Kohëzgjatja: 9 ditë - Lokacioni: Teatri "Migjeni," Shkodër																
1. Netët Tematike të Komedisë dhe Humorit:																
Festivali ka një strukturë të diversifikuar, duke ofruar për çdo natë një tematikë të veçantë që përfaqëson zhanre dhe stile të ndryshme të komedisë dhe humorit, duke përfshirë teatro nga e gjithë Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe disa shtete të europës.																
2. Elemente të reja për një atmosferë miqësore dhe festive:																
Për të forcuar atmosferën festive dhe për të nxitur bashkëpunimin, festivali i këtij viti përfshin aktivitete të reja që krijojnë hapësira për lidhje dhe komunikim të hapur midis artistëve dhe publikut: - Punëtori të hapura për publikun dhe artistët e rinj: Punëtori për artistët e rinj që duan të zhvillojnë aftësitë e tyre në komedi dhe stand-up comedy. Këto punëtori udhëhiqen nga artistë me përvojë dhe janë të hapura për të gjithë, duke krijuar një mundësi për të eksploruar zhanrin komik në thellësi. - Diskutime dhe sesione ndërveprimi midis artistëve dhe publikut: Çdo natë do të ketë hapësirë për diskutime të lira midis artistëve dhe spektatorëve, duke nxitur një atmosferë të afërt dhe të përzemërt. Ky format krijon një lidhje më të ngushtë midis artistëve dhe publikut, duke i dhënë mundësinë këtij të fundit të ndajë mendime dhe komente.																
<table><tr><th>Çmimet e festivalit të detajuara</th><th></th></tr><tr><td>Shfaqja më e mirë</td><td>200</td></tr><tr><td>Regjia më e mirë</td><td>150</td></tr><tr><td>Aktori më e mirë</td><td>100</td></tr><tr><td>Aktorja më e mirë</td><td>100</td></tr><tr><td>Artisti i ri më e mirë</td><td>50</td></tr><tr><td>Çmimi i karrierës</td><td>150</td></tr></table>			Çmimet e festivalit të detajuara		Shfaqja më e mirë	200	Regjia më e mirë	150	Aktori më e mirë	100	Aktorja më e mirë	100	Artisti i ri më e mirë	50	Çmimi i karrierës	150
Çmimet e festivalit të detajuara																
Shfaqja më e mirë	200															
Regjia më e mirë	150															
Aktori më e mirë	100															
Aktorja më e mirë	100															
Artisti i ri më e mirë	50															
Çmimi i karrierës	150															
ii. Synimi i projektit																
Me ane te realizimit te ketij projekti neTeatri " Migjeni synon : - Të edukojë spektatorin, sidomos te rinjte që përmes komedisë dhe artit të aktrimit, festivali synon të nxisë mendimin kritik dhe kreativitetin te të rinjtë, duke i përfshirë ata në një eksperiencë që edukon dhe frymëzon. - Të argëtojë dhe të afrojë spektatorin e të gjitha moshave me Teatrin: Duke përdorur një gjuhë artistike të qartë dhe moderne, festivali synon të bëjë teatrin më tërheqës për audiencën të ndryshme, nga të rinjtë tek të moshuarit, duke përçuar humor dhe mesazhe sociale. - Të rrisë numrin e spektatorëve: Përmes diversitetit të zhanreve dhe stileve komike, festivali synon të tërheqë një numër më të madh spektatorësh dhe të krijojë një audiencë të qëndrueshme për aktivitetet e ardhshme të teatrit. - Të zgjerojë repertorin e aktiviteteteve të Teatrit: Duke përfshirë lloje të ndryshme komedie dhe artistësh nga trevat shqiptare dhe më gjerë, festivali pasuron repertorin e Teatrit "Migjeni" dhe ndihmon në përforcimin e tij si një qendër e rëndësishme kulturore. - Të gjenerojë të ardhura për aktivitetet e ardhshme: Pjesëmarrja e gjerë dhe shitja e biletave do të kontribuojnë në mbledhjen e fondeve për të mbështetur projekte të tjera artistike dhe për të siguruar qëndrueshmëri financiare për institucionin.																
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)																

- Procedurat e Përgatitjes së Shfaqjeve dhe Festivalit Procedurat e përgatitjes së shfaqjes Perzgjedhja e shfaqjeve pjesemarrese Perzgjedhja e artisteve pjesmarres Efektet speciale (ndriçimi, fonia, etj.). Përcaktimi i figurës artistike nga ana pamore (grimi, parukjeria). Puna në skenë e koordinuar me të gjithë elementet skenik (ndriçim, foni, efekte speciale,grim, parukeri, video, audio, publiciteti, banera, postera etj). Prova gjenerale përmbyllëse dhe premiera per cdo shfaqje pjesemarrese ne festival. - Realizim i proçedurave per Shpenzime për Honorar dhe Logjistikë Realizim i proçedurave shpenzimeve per Transport i pjesmarresve nga qytetet e tyre Realizim i proçedurave për shpenzime për Akomodimi i pjesmarresve ne hotel ne netet e zhvillimit te aktivitetit - Organizimi i Shfaqjeve të Festivalit sipas Kalendarit. - Organizimi I juries per ndarjen e cmimeve. Mikpritje dhe plotësim i çdo kushti për çdo trupë teatrore që do marri pjesë në festival.						
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)						
• Shfaqje me cilësi • Numër në rritje të spektatorëve. Presim që nga tematika që ofron kjo shfaqje të afrojme me Teatrin një target grup moshash gjithpërfshirës.						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)				d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)		
• Artistët, aktorët e teatrit • Stafi mbështetës Aktore nga gjitha trevat e shqiperise				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura (për cdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A1.1	Teatro Honorare të ftuar (8 x 200)	1,600			1,600	
A1.2	Shpenzime Akomodimi + Trajtim ushqimor	795			795	
A1.3	Honorare Video Maker (1 x 70)	70			70	
A1.4	Honorare Të ftuar nderi (8 x 50)	400			400	
A1.5	Shpenzime pritje Percjellje dhe mbrëmja gala	180			180	
A1.6	Honorare Çmimet e festivalit	700			700	
A1.7	Honorare Juria (5 x 50)	250			250	
	Shuma	3,995			3,995	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pjese Teatrore:	3,995			3,995	
	Shuma	3,995			3,995	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pjese Teatrore:	3,995			3,995	
	Shuma	3,995			3,995	
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Maj 2026		Bashkia Shkodër				
Maj 2027		Teatri Migjeni				
Maj 2028		Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.37	P.AF141.Q2.O3.A17 Realizimi I aktiviteve te Galerise se Arteve	AF141 Sport dhe Kulture
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Galeria e arteve per vitin 2025 ka realizuar aktivitetet e parashikuara, te cilat do te vijojne te parashikohen edhe per vitin 2026, si me poshte:		
Programet të edukimit artistik në partneritet me individë dhe shoqata kulturore - Në hapësirën lokale operojnë faktorë të ndryshëm kulturorë, bashkëpunimi me të cilët është në interes të të gjithë komunitetit ashtu si dhe të institucioneve e subjekteve të përfshirë. Për këtë arsye, Galeria e Arteve, është e interesuar të angazhohet si partner në projekte të përbashkëta me të tretë, individë, shoqata etj. në përfitim të aktiviteve kulturore gjurmëlënëse dhe me një impakt pozitiv në mjedisin ku zhvillohen, me një qëllim konkret edukimin e grupeve të interesuara përmes programeve të edukimit artistik që si synim kanë krijimin e mundësive shprehese dhe evidentimin e mundësive të zhvillimit të talenteve në fusha të caktuara artistike. Ne vitin 2025 u realizua Programi I Edukimit 2025, në bashkëpunim me Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkoder, e cila u udhëhoq nga Profesoret e Univesitetit dhe Artistja Znj. Lebibë Topalli nga Ferizaj I Kosovës. Ky program mbledhi rreth vetes studente të Departamentit të Arteve të Universitetit. "Luigj Gurakuqi" Shkoder dhe kishte për qëllim përdorimin e hapësirës publike universitare në realizimin e një muraleje me qëllim delegimin e mesazheve të shpresës dhe mbështetjes për artin. Vlera totale për këtë program planifikohet të jetë : për shpenzime akomodim dhe trajtim ushqimor për të ftuar 20 mijë leke, honorare për 1 person do të jetë në vlerën 20 mijë leke ,shpenzime transporti brenda dhe jashtë vendit është planifikuar 10 mijë leke, pra në total 50 mijë leke		
